

BIBLIOTEKA E

8514 - 94

SHEFTI

X H 23

GJIROKAS FLR

SPIRO XHAI

Llamba  
e  
minatorit  
ndriçon



85H-94  
XH 23

85H-94  
A

BIBLIOTEKA E RINISË

---

SPIRO XHAI

R

LLAMBA E MINATORIT  
NDRIÇON

~~49559~~

(Nga jeta e një heroi të punës socialiste)

35977

BIBLIOTEKA E SHITETI  
SHKURTORJA

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHERI»

## I. NË VEND TË PARATHËNJES

Heroi i këtij libri nuk është një personazh letrar, i krijuar nga fantazia e shkrimtarit, po një njeri i ditëve tona. Ai rron e punon në mes të një kolektivi të madh minatorësh, që e do dhe e nderon, mbasi edhe ai e do me gjithë shpirt dhe nuk i ndahet kurrë.

Lexuesi i librit, kur të marrë vesh për cilin bëhet fjalë, ka për të thënë me siguri: «U! Unë këtë emër e kam dëgjuar më se një herë!».

Po, i dashur lexues, emrin e tij e ke dëgjuar e ndoshta e ke lexuar edhe në gazetë. Shumëkush mund t'i ketë parë edhe fotografinë, që e paraqet me një llambë minatori të varur përpara, duke u futur në një nga galeritë e shumta të minierës së kromit në Bulqizë. Ai është anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe deputet i Kuvendit Popullor! Në fillim të vitit 1968, me rastin e njëzetvjetorit të minierës së Bulqizës, Presidiumi i Kuvendit Popullor e shpalli Hero të Punës Socialiste. Dhe këtë gjë e mori vesh gjithë Shqipëria...

Ata që morën pjesë në ceremoninë e dorëzimit të këtij titulli të lartë, thanë në kinemanë e Bulqizës: «Ai e meriton plotësisht këtë nder të madh që ju bë nga Partia». Shumë të tjerë, që e kishin njohur në luftë apo më vonë në punë për ndër-

timin e Shqipërisë së re, filluan të kallëzojnë ngjarje dhe episode nga jeta e tij. Atëhere më lindi edhe mua idea për të shkruar këtë libër të vogël për kryeinxhinierin e minierës së Bulqizës, Todo Mançon.

Shokët e tij të punës ma përkrahën me zjarr këtë mendim. Po ai, Todua, kur e mori vesh se ishte fjala për të, tha me çiltërsi:

— Shkruaj më mirë për kolektivin e mreku-lueshëm të minierës sonë, që lufton ditë e natë në thellësi të nëntokës, për t'i dhënë atdheut sa më shumë mineral kromi.

— Këtë radhë nuk jemi të një mendimi me Todon, — thanë shokët e tij minatorë. — Ai është pjesëtar i kolektivit tonë prej afro pesëmbëdhjetë vjetësh dhe ne e njohim mirë. Ndaj e themi me plot gojën se duhet shkruar një libër për të. Ne do ta kemi për nder një gjë të tillë. Se nga jeta e tij njerëzit, e sidomos të rinjtë, mund të mësojnë shumë.

Në atë çast, inxhinieri i ri, Niko Lula, që rrinte si i menduar e dëgjonte fjalët e të tjerëve, tha me bindje të plotë e sikur fliste në emër të të gjithëve:

— Për atë s'mjafton një libër, or shokë !..

## II. HAPAT E PARA NË JETË

Brëzë malit Moravë, në afërsitë e qytetit të Korçës, shtrihet fshati i bukur Boboshticë. Prej së largu fshati i bleruar të jep përshtypjen e një

kopshti të madh, në mes të pllajës së zhveshur të malit dhe fushës së punuar. Jo shumë larg fshatit kalon rruga që të çon në minierën e qymyrit Mborje - Drenovë.

Në këtë fshat të madh lindi Todua. Ai kaloi këtu vitet e fëmënisë dhe të rinisë së parë. Ishte koha që maleve sapo kishte pushuar pushka për lirinë dhe pavarësinë e vendit. Pushtuesit e huaj vërtet ishin shporrur nga vatani, po tokën dhe pasuritë e tjera të Shqipërisë i kishin mbajtur përsëri në duart e tyre agallarët dhe pasanikët e tjerë. Popullit i kishte mbetur rishtas në pjesë skamja dhe varfëria.

I ati i Todos, mëngjez për mëngjez, me dy-tre libra nën sjetull, merrte rrugën e shkollës. Ai u mësonte fëmijëve të fshatarëve gjuhën e ëmbël të Naimit.

Në shkollën e fshatit të lindjes Todua mësoi shkrim e këndim, aty mbaroi mësimet e shkollës fillore. Mirëpo edhe gjatë kësaj periudhe, kur ishte kohë e mirë, ai merrte një copë bukë në dorë dhe me çantën e shkollës në krah shkonte në arë për t'i ndihmuar nënës në punët bujqësore. Atje edhe përgatiste mësimet për ditën e nesërme, edhe prashiste e mbillte. Kështu i lindi në shpirt djalit të vogël dashuria për punë që është një nga tiparet themelore të karakterit të tij.

Atëhere, në të hyrë të fshatit të Todos ngriheshin disa shtëpi të larta e të bukura. Ato ishin shtëpitë e pasanikëve të Boboshticës. Prapa tyre shtriheshin shtëpi të vjetra përdhese të fshatarëve të varfër, që rropateshin ditë e natë në punë e mezi arrinin të nxirrnin bukën e gojës. Ky ndry-

shim i kishte rënë në sy Todos së vogël, ndoshta më tepër se e shikonte edhe në mes të fëmijëve që ishin moshatarë me të: një numër i vogël nxënësish të shkollës ishin të veshur mirë dhe s'u mungonte asgjë, ndërsa pjesa më e madhe ishin shumë të vobektë; kishte fëmijë që edhe në dimër vinin zbathur në shkollë.

«Pse ndodh kjo?» pyeste veten djali i vogël, pa arritur ta shpjegonte këtë gjë me mendjen e tij prej fëmije. Dhe sot, kur Todua kujton kohën e fëminisë, thotë:

«Sot ajo kohë më duket si një ëndërr e largët, po që më ka lënë mbresa të pashlyeshme në shpirt. Qysh atëhere më ka lindur mendimi se, midis të pasurve dhe të varfërve bëhet një luftë e fshehtë, po e pamëshirshme. Atje, në fshat, shikoja se si fëmijët e pasanikëve përbuznin ata të të varfërve. Po edhe këta të fundit i urrenin djemt e pispillosur të shtëpive të mëdha. Shumë herë fëmijët e pasanikëve ndaheshin mënjanë dhe nuk i qasnin në lodrat e tyre fëmijët e vobektë. Kështu fillonte një ndarje, një luftë midis fëmijëve të fshatit. Unë s'kam qënë i pasur, po as edhe i varfër. Im atë, si mësues fshati që ishte, arrinte të na mbante disi më mirë, kështu që djemt e pasanikëve shpesh më ftonin të shkoja me ta. Po mua kurrë nuk më pëlqente shoqëria e tyre. Dëshira ime ishte të bashkohesha me fëmijët e tjerë të fshatit, me të varfërit, që përbënin shumicën. Nuk më harrohet një ngjarje që, në vështrim të parë duket e vogël, por, po ta analizosh, ka kuptim të thellë. Në fshatin tonë bie shumë dëborë. Dhe dëborë mban për ditë

e javë me radhë. Një ditë plasi lufta me topa dëbo-re. Fëmijët u ndanë në dy fronte, në dy barrikada: nga njëra anë qëndronin të pasurit, nga ana tjetër ata, të varfërit. Të parët më thirrën: «Todo! Eja me ne! Eja me ne!» Po unë, pa ngurrimin më të vogël, u bashkova me të varfërit. Ata atëhere nisën të thër-rasin: «Todua është yni. Është yni!» Unë ndjeva një gëzim të madh në shpirt. Lufta u ndez e ashpër. Në një çast të volitshëm ne ndërmorëm një sulm të rreptë, i morëm përpara këmba - këmbës kundërshtarët tanë dhe i dërmuam fare».

Përpara fshatit Boboshticë shtrihet si një det i madh fusha e bukur e Korçës. Po atëhere kjo fushë e begatë nuk ishte ashtu siç është sot. Todua dilte në dritaren e shtëpisë dhe kundronte këtë fushë të pafund, që fillonte në këmbë të Moravës dhe humbiste thellë, në horizont. Rrëzë kodrave e bregoreve dalloheshin shtëpitë e fshatrave fqinjë. Pranë çdo fshati dukej një rrip toke e punuar dhe e mbjellur; pak më tutje s'kish më të mbjella, po vetëm kallama të gjatë, ku fshiheshin egërsirat. Aty ishte kënetë, kënetë e madhe e Maliqit, që mbulonte tokat më të mira të kësaj fushe shumë pjellore. Nga kënetë e mallkuar dilnin re mushko-njash, që përhapnin kudo ethet e malaries.

«Si është bërë kjo kënetë e madhe? Si është mbuluar kjo fushë nga uji i turbullt?» Habitej Todua i vogël. Dhe një ditë gjyshja i tha:

«Në kohra shumë të lashta, fusha nuk ishte e mbuluar me ujëra. Ajo punohej e mbillej e tëra, gjer atje ku është tani kërthiza e kënetës. Më vonë thonë se doli një kuçedër e steruar dhe zuri ngu-shticën nga derdheshin ujrata në lumë... Tani ku-

çedra e ka humbur kyçin e ujrave dhe nuk lë njeri që t'u hapë rrugë...»

«Po pse s'e vrasin kuçedrën, moj gjyshe?» — e ndërpreu djali kureshtar.

«Kush ta vrasë, mor bir? Ajo është e madhe, e fortë...»

«Gjithë këta njerëz që ka këtu rreth fushës!...».

«Ka vërtet shumë njerëz, po janë të ndarë. Që të maten me kuçedrën, duhet të bashkohen e të bëhen një, si gishtat e grushtit.»

«Po pse s'bashkohen atëhere?»

«Kush t'i bashkojë pa, janë me mijëra...».

Djali ra në mendime. «Vërtet. Kush mund t'i bashkojë ata» — thoshte me vete. Po përgjigje s'mund të gjente.

I ati i Todos tregonte shumë gjëra për kënetën dhe për vuajtjet e fshatarëve të fushës. «Ata të malësisë — thoshte ai — vuajnë se s'kanë fare tokë. Këta të fushës vuajnë sepse zotër janë agallarët; tokat e tyre arrijnë gjer te streha e kasolleve të fshatarëve të varfër. Këta janë kuçedra, që thotë gjyshja...»

Nga kënetat e Maliqit dalin mushkonjat që i pickojnë dhe u thithin gjakun fshatarëve. Po njëqind herë më të rrezikshëm se mushkonjat e kënetës janë bejlerët e agallarët, që ua thithin gjakun fshatarëve të varfër si shushunja të pangopura...» Djali i vogël rrinte i menduar kur dëgjonte fjalët e të jatit.

Shpeshherë Todua shihte grumbuj fshatarësh, që përcillnin njerëzit e tyre për në kurbet. Qanin gratë, qanin fëmijët, qanin edhe burrat që



merrnin rrugën e kurbetit të zi dhe linin njerëzit e tyre në fshat.

Njëherë u nis për në kurbet, për në Argjentinën e largët, një fqinj i Todos. Njerëzit e shtëpisë, farefisi dhe miqtë e përcollën gjer te rruga e madhe. Bashkë me ta vajti edhe Todua dhe u prek shumë kur pa të jëmën e fqinjit që qante me ngashërim. Kur u kthye në shtëpi, i tha të jatit:

—Baba, përse ikin njerëzit nga fshati ynë e shkojnë në kurbet?

— Se mos ikin vetëm nga fshati ynë! — ju përgjegj si i menduar i ati.

— Pse, ikin edhe nga fshatra të tjerë?!

— Posi! Përditë.

— Pse ikin?

— Sepse këtu nuk gjejnë punë, or djalë!  
Kërkojnë punë kudo, po nuk gjejnë.

— Po pse s'gjejnë punë?

— Nuk gjejnë punë, se s'ka ...

— Pse s'ka, pa?

— Ohu! Ti je i vogël ende. Pse kërkon të merresh gjithnjë me gjëra të mëdha? Shiko mësimet tani. Kur të rritesh, do t'i marrësh vesh të gjitha ...

Todua u mat njëherë t'i thoshte: «Ka shumë gjëra që s'kuptoj, baba. Ti më thua se nuk ka punë dhe njerëzit largohen nga vendi e shkojnë prapa diellit. Xhaxhi Miti thotë se nuk i mjafton toka, jo vetëm atij, po gjithë bujqve të varfër, që s'kanë tokë të tyre. Gjithë kjo fushë këtu te ne dhe ata thonë se s'kanë tokë! Lere kënetën pastaj, që e...»

Po në çastin e fundit vendosi të mos thoshte

gjë dhe heshti, sepse kishte frikë mos nxehej i ati.

Përgjigjen e këtyre pyetjeve, që e shqetësonin shumë, e gjeti shumë më vonë ...

### III. KOMUNISTI I ORËS SË PARË

Todua mbaroi shkollën e fshatit. Dëshira e tij për të vazhduar shkollën që e madhe, po gjendja ekonomike e familjes nuk ishte e mirë. I ati llogariste dhe e shihte se nuk mund ta mbante djalin në qytet për të vazhduar mësimet në shkollën e mesme. Po sikur të shkonte në mëngjez në shkollë e në mbrëmje të kthehej në shtëpi? Kjo ishte shumë e vështirë dhe kërkonte një vullnet të fortë. E thirri të birin dhe i tha:

— Dëgjo këtu, Todo. Ti nuk je më i vogël dhe i kupton hallet e shtëpisë. Ne, prindët e tu, kemi dëshirë që ti të vazhdosh mësimet, po jemi hollë nga ana ekonomike. Në qytet s'mund të të mbajmë, se duhen shpenzime të mëdha: jo për të ngrënë, jo për të fjetur... Të shkosh përditë në shkollë e të kthehesh përnatë në fshat është një punë tepër e vështirë...

— E vështirë është, baba, po unë ashtu do të bëj, — ju përgjegj Todua, sikur ta kishte përgjigjen gati prej kohe.

— Mendohu mirë njëherë, se nuk është shaka. Nuk është një ditë e dy. Janë vite të tëra këto. Pastaj vjen dimri me shira, me dëborë e me ngrica...

— I kam menduar të gjitha.

— Mirë, pra, megjithatë mendohu edhe njëherë. Se, po të lodhesh pastaj e ta lësh shkollën në mes, është më keq, sa të mos e fillosh fare.

— Do ta shohësh, baba, që nuk do të ngec në baltë. Punën e shkollës do ta çoj gjer në fund, — i tha djali me vendosmëri të plotë...

Të nesërmen u regjistrua në Liceun e Korçës dhe një mëngjez herët u nis nga fshati i lindjes e mori rrugën për në qytet. Në krahë kishte hedhur një çantë, të qepur në shtëpi, me disa libra brenda e një copë bukë me djathë. Në mbrëmje u kthye në shtëpi dhe, pa u çlodhur mirë, filloi të pregatisë detyrat për ditën tjetër.

Kjo vajtje-ardhje nga fshati në qytet e nga qyteti në fshat vazhdoi disa vjet me radhë: me kohë të mirë e me kohë të keqe, me shi e dëborë, me erë e me shtrëngatë. Sigurisht, nuk ishte punë e lehtë. Po vetë jeta e bindte djalin, ndonëse ishte në moshë të njomë, se shkolla nuk fitohej lehtë e duke ndenjtur, po me punë, me mund e me djersë...

Djali nga Boboshtica, që vazhdonte tani mësimet në Liceun e Korçës, mendonte se do t'i gjente në librat e shkollës përgjigjet për gjithë sa që e mundonin. Ditët kalonin, ai mësimet i mëson-te mirë, detyrat e shkollës i kryente me zell, po sqarime për çështjet që ende i kishte të errëta në mendjen e vet, nuk gjente as në libra, as në shpjegimet e profesorëve. Përkundrazi, çështjet e errëta e të paqarta shtoheshin përditë e më shumë. Jeta e qytetit i dukej edhe më e koklavitur. Çdo ditë haste në probleme të reja, që ishin më të ngatërruara se ato të fshatit. Në orët e lira dilte shpesh rrugëve të qytetit dhe vërente me vëmendje çdo gjë.

Në qytet kishte kamje e luks, po kishte më shumë skamje e varfëri. Ai shihte zonja të veshura sipas modës, që hynin e dilnin nëpër dyqanet luk-

soze të qendrës, po jashtë këtyre dyqaneve, nëpër këndet e rrugëve, në trotuarët, zgjatnin duart e tyre të nxira nga të ftohtit lypsit e mjerë, për të kërkuar lëmoshë...

Ku e kishte burimin një pabarazi kaq e madhe dhe një padrejtësi që binte menjëherë në sy? Sado që mundohej nxënësi i klasës së parë të Liceut të Korçës, nuk mund ta gjente vetë përgjigjen.

Një ditë, rrugët e qytetit u mbushën me njerëz, që si përrenj të vrullshëm derdheshin drejt qendrës, duke bërtitur me të madhe: «Bukë! Bukë! Duam bukë!». Djali pa midis tyre shumë nxënës të Liceut, pa edhe disa burra nga fshati i tij; u fut edhe ai midis njerëzve që kërkonin bukë. Në atë çast dolën xhandarët të armatosur gjer në dhëmbë. Po demonstruesit nuk u friksuan. Xhandarët u lëshuan si të tërbuar kundër punëtorëve dhe fshatarëve të uritur. Filloi përleshja. Xhandarët i goditnin njerëzit pa mëshirë me shkopinj e me koditnin e pushkëve. Djaloshi nuk ishte në vijë të parë të përleshjes, po i dukej sikur të goditurat e xhandarëve binin mbi kurriz të tij...

Atë mbrëmje u kthye në shtëpi më vonë se herët e tjera.

— Ç'u bëre, mor bir? — i tha e ëma e shqetësuar.

— Tani erdha, nëno.

— Ne morëm vesh se atje në qytet u bë një kacafytje e madhe me xhandarët dhe na vajti mendja për keq.

— Po, nëno, ndodhi...

Todua u kallëzoi pastaj njerëzve të shtëpisë

për demonstratën e madhe të bukës në Korçë. Ai nuk fliste si për një ngjarje që e kishte parë prej së largu, por si pjesëmarrës i saj.

— Po ti ku ishe, mor djalë, gjatë përleshjes me xhandarët? — e pyeti me një shqetësim të përmbajtur i ati.

— Në mes të njerëzve, baba. U bashkova edhe unë me ata që kërkonin bukë.

I ati i hodhi një vështrim hetues, po nuk e qortoi, as që i tha gjë. Ai e kuptoi mirë se nuk kishte të bënte më me një çunak të drojtur, po me një djalë që kërkonte të gjente rrugën e vërtetë të jetës...

«Disa ditë pas demonstratës, — kallëzon tani Todua, — m'u afrua një nxënës i klasave të larta. Ai më foli për demonstratën, për përleshjen me xhandarët e për shumë gjëra të tjera. Unë i hapa pak nga pak zemrën dhe i bëra fjalë për ato gjëra që përpiqesha t'i shpjegoja me mendjen time e me anë të librave, po që s'arrija dot në asnjë përfundim. Ai buzëqeshi, pastaj më tha me bindje: «Sqarimet dhe shpjegimet që kërkon ti, nuk do t'i gjesh dot as në librat e shkollës, as në gazetat që shiten në pazar. Eja me ne dhe pak nga pak do t'i kuptosh të gjitha».

Qysh atë ditë u bashkova me anëtarët e grupit komunist të Korçës. Dhe mund të them me plot gojë se qysh atë ditë filluan të më hapen sytë.

Nuk vonoi shumë dhe gjërat më të errëta e më të vështira u bënë për mua të qarta si drita e ditëllit. Bashkë me shokë të tjerë të grupit, që vepronin në Lice, punonim në shkollë dhe jashtë shkollës për të përhapur idetë komuniste. Sipas

udhëzimeve që na vinin, shpërndanim trakte e materiale të tjera në masat e popullit. Aktiviteti ynë në lice u shtua shumë kur u dukën shenjat e para të pushtimit fashist. Këto paralajmëronin një stuhi të madhe për vendin tonë. Sado që fletushkat e kohës përpiqeshin ta vinin popullin në gjumë, duke thënë se Shqipërisë nuk i kanosej asnjë rrezik nga jashtë, ne e kishim të qartë se e keqja trokiste te dera... Në ato ditë të stuhishme, para 7 prillit 1939, rinia ishte në radhët e para të popullit që u ngrit dhe që kërkonte armë për të luftuar kundër këmishzinjve të Musolinit. Shkolla jonë ziente nga urrejtja më e thellë kundër fashizmit italian. Megjithëse më 7 prill vendi ynë u pushtua nga hordhitë fashiste, flaka e urrejtjes kundër armikut jo vetëm nuk u shua, po u bë edhe më e fortë, dhe një ditë do të shpërthente me një forcë të papërmbajtur...»

Pas pushtimit të vendit fillon periudha e vështirë e rezistencës popullore. Pushtuesit fashistë e ndjenin mirë se shkelnin mbi një vullkan gati në shpërthim. Prandaj filluan me dinakëri një punë sistematike për të mashtruar e korrumpuar rininë. Këtë taktikë ndoqën edhe në Liceun e Korçës, që ishte një vatër e shëndoshë e lëvizjes antifashiste të asaj kohe.

Kishin kaluar vetëm disa javë nga dita e zezë e 7 prillit. Në Liceun e Korçës vihej re një lëvizje e madhe. Atje hynin e dilnin vetura luksoze me zyrtarë të lartë të fashizmit. Nxënësit parandjenin se diçka ziente. Ata që ishin të organizuar në grupin komunist të Korçës, e kuptonin qartë se fashistët po vinin në zbatim planin e tyre për të

gënjyer e për të bërë me vete të rinjtë që studjonin në Lice. Prandaj bënin sytë katër, që ta hidhnin në erë planin fashist.

Një ditë të bukur pranvere, në një nga klasat e larta të Liceut, bashkë me mësuesin e gjuhës, hyri edhe drejtori i shkollës, i caktuar rishtas aty, si njeri i besuar i fashizmit. Nxënësit, kur e panë që hyri në klasë drejtorin e urryer, shikonin njëri tjetrin të shqetësuar.

Klasa, sipas programit, kishte hartim. Mësuesi, me një buzëqeshje të shtirur në fytyrë, u dha si temë frazën e Musolinit: «Shqipëria është në zemrën time». Emri i diktatorit të urryer i bëri nxënësit nervozë. Disa nga ata shtrënguan grushtet nga urrejtja. Drejtori vështroi me shqetësim fytyrat e zemëruara të nxënësve dhe gjeti një shkak për të dalë nga klasa. Mësuesi dha disa shpjegime. Dhe përfundoi: «Tani merrni penat dhe shkruani. Bëni një hartim të bukur, ashtu siç është edhe vetë tema. Hartimet e mira do t'i lexojmë përpara gjithë shkollës, kurse atë më të mirin do t'ja dërgojmë vetë Duçes».

Në klasë ra një qetësi e thellë. Nxënësit mendoheshin. Si duhej bërë? Duart qëndronin të palëvizura. Asnjë s'e merrte penën për të shkruar. Letrat mbi bankat e zeza mbeten të bardha. Befas një nxënës zeshkan, nga banka e fundit, u ngrit në këmbë.

— Doni gjë? — i përshpëriti mësuesi.

Nxënësi nuk u përgjigj.

— Përse nuk shkruani? — e pyeti për së dyti mësuesi.

Nxënësi zeshkan, me nofulla të shtrënguara, e

vështroi njëherë me urrejtje, pastaj mori letrën e bardhë të hartimit dhe e bëri copë - copë.

— Ç'po bën! Ç'po bën! Ku do të shkosh, — ngriti zërin mësuesi. Po nxënësi zeshkan as që e përfilli fare. Ai u drejtua nga dera me hap të vendosur. Para se të hapte derën, ktheu njëherë kokën nga klasa dhe u hodhi një vështrim të shpejtë të gjithë nxënësve. Oh, sa kuptimplotë ishte ai vështrim i shpejtë i shokut të tyre!

Mësuesi u drejtua nga dera, që t'i fliste edhe njëherë nxënësit të revoltuar. Ai shpresonte se në çastin e fundit do ta bindte të kthehej, që të shkruante hartimin. Po pa arritur t'i thoshte ndonjë fjalë, nxënësi hapi derën me vrull ja përplasi me forcë mu në fytyrë mësuesit, dhe doli në mesore.

«Toda e bëri fora!» — pëshpëriti klasa. Pastaj u ngrit një nxënës tjetër dhe grisi fletën e hartimit. Pas tij një tjetër e një tjetër...

Lajmi se nxënësit e klasave të larta nuk deshën të shkruanin hartimin me temë që përbëhej nga një frazë e Musolinit, u përhap si vetëtimë jo vetëm në Lice. po në gjithë qytetin. Drejtorja e shkollës dhe autoritetet fashiste u alarmuan. Flitej se do të merreshin masa të rënda. Po atmosfera e shkollës ishte shumë e ndezur. Fashistët e kuptuan se, po të fillonin nga dënimet, do të shkakëtonin një zemërim edhe më të madh në radhët e nxënësve. Prandaj u mjaftuan vetëm të marrin informata për nxënësit më aktivë në lëvizjen antifashiste. Marrjen e masave e shtynë për më vonë. Nxënësit e organizuar nuk u gënjyen nga kjo taktikë e fashistëve; ata e dinin se fashizmi përdor, sipas rastit, taktikën e ujkut, ose të dhelprës...



Si në gjithë vendin, edhe në Lice lufta vazhdoi gjithënjë më e ashpër e mori forma të reja.

Një ditë, drejtori i Liceut dha urdhër që të gjithë nxënësit duhet të përshëndesnin ala-fashiste, duke ngritur dorën lart. Nxënësit e organizuar në grupin komunist të Korçës ju përveshën menjëherë punës për ta sabotuar edhe këtë masë fashiste.

Mëngjes. Po afron ora e fillimit të mësimëve. Drejtori i Liceut, bashkë me disa nga profesorët që i shkojnë pas, del në oborrin e shkollës. Është dita e parë që nxënësit, duke hyrë në shkollë, do të përshëndesin duke ngritur dorën. Te dera e jashtme janë grumbulluar disa nxënës, që nuk dinë si të veprojnë. Tek tuk ndonjë nxënës nga ata të familjeve të pasura hyn në oborr dhe përshëndet sipas mënyrës fashiste. Drejtori buzëqesh i kënaqur. Pak nga pak te hyrja e oborrit grumbullohen nxënësit e organizuar. Në atë çast arrin nga fshati edhe Todua. Është i djersitur nga rruga, po gjaku i rinisë i vlon në dej. Futet në mes të shokëve. Plani është i qartë. Ata do të hyjnë në shkollë të gjithë së bashku, pa e përshëndetur fare drejtorin fashist. Grumbulli i nxënësve u afrohet shkallëve. Drejtori krekoset si gjel në krye të shkallëve. Ai pret të shikojë duart e nxënësve të ngrihen lart dhe të përshëndesin ala-fashiste. Po nxënësit hynë brenda pa kthyer fare kokën nga ana e tij. «Ç'po ndodh? Ç'do të thotë kjo?» — belbëzon drejtori me vete. Ai e kupton se kjo është një mosbindje e hapur. Jo vetëm kaq. Kjo do të thotë revoltë.

Alarm në shkollë. Lajmërohen menjëherë autoritetet fashiste. Shkolla rrethohet nga forcat e karabinierisë, mësimet ndërpriten...

~~49559~~ 35988  
MILITARIA E SHIR... 17  
GURKOSTEF

Ato ditë që shkolla mbeti e mbyllur, shokët e grupit e lajmëruan Todon të mos dilte në qytet. Autoritetet fashiste po përgatiteshin të bënin arrestime në radhët e rinisë dhe emri i tij duhet të ishte në krye të listës. Bisha fashiste po fillonte të tregonte dhëmbët e ujkut...

Ngjarjet e Liceut dhe shumë të tjera të këtij lloji kudo në Shqipëri tregonin se rezistenca kundër pushtuesit po përhapej me shpejtësi në të gjitha anët e vendit. Po rrëketë e shumta të qendresës së popullit kundër fashizmit duheshin bashkuar në një lumë të madh, që, me valët e tij të fuqishme, do t'i mbyste e do t'i zhdukte nga faqja e dheut pushtuesit e huaj dhe bashkëpunëtorët e tyre vendas. Dhe kjo forcë e madhe organizuese u gjet. Më 8 Nëntor 1941, në Tiranë u themelua Partia Komuniste Shqiptare. Todua u bë menjëherë anëtar i partisë së porsakrijuar. Në triksën e tij të partisë shënohet: «Anëtar partie i vitit 1941».

#### **IV. SOT LYPSET ME ARME MALIT TË DALIM!**

Si gjithë anëtarët e tjerë të shëndoshë të grupeve komuniste, edhe Todo Mançua themelimin e Partisë Komuniste Shqiptare e priti me gëzim të madh. «Nuk mund të thuhet me fjalë, — na thotë ai vetë, — se çfarë ndjeva kur mora vesh nga shokët se në Tiranë ishte themeluar partia jonë, Partia Komuniste Shqiptare. Ne e prisnim me padurim këtë lajm dhe ishim të sigurtë se partia do të krijohet, se ky ishte vullneti i një

populli të tërë. Krijimin e partisë e kërkonte situata. Ndaj atë ditë të zyrtë nëndori, që na erdhi ky s'hariq i madh, na u duk sikur u bë menjëherë pranverë. Në rrugët e Korçës qar-kullonin ditë e natë fashistë italianë të armatosur gjer në dhëmbë, po tani na dukeshin si të pa-fuqishëm e si kufoma që po u afrohej ora e va-rrimit. Duke përgëzuar shoku shokun për kriji-min e partisë, na dukej sikur forca jonë ishte qindfishuar menjëherë. Ngjarjet që u zhvilluan më vonë, vërtetuan se ne kishim plotësisht të drejtë ...»

Po fillonte perjudha e betejave të mëdha, e betejave të ashpra e vendimtare për fatet e po-pullit e të atdheut. Komunistët, të pakët në nu-mër atëhere, u caktuan në frontet më të vësh-tira të luftës. Komiteti Qarkor i Partisë Komu-niste për Korçën e dërgoi Todon si sekretar të celulës në fshatrat Boboshticë - Drenovë - Ra-voNIK. Një ditë dimri me llohë e me ngricë, To-dua u nis nga qyteti për në fshatin e lindjes. Tani nuk shkonte më për të kaluar natën, po për të ngritur banorët e tre fshatrave në luftën çlirimtare kundër pushtuesve. Todua mund të shkonte edhe me sy të mbyllur në fshat, po tani nuk kalonte më nga rruga e zakonshme; ai ecte rrzë malit, andej nga mund të mos i shkonte mendja armikut, që e ndiqte këmba këmbës. Në fshat filloi menjëherë punën për ngritjen e ce-lulës së partisë.

«Në fillim celula ishte fare e vogël, — thotë Todua.—Ajo përbëhej prej tre-katër vetësh. Pasi pu-nuam ca kohë, arritëm ta forconim celulën tonë me

elementë të rinj nga të tre fshatrat. Nuk kaloi shumë dhe ajo u bë me tetë anëtarë. Mund të duket një numër i vogël, ë? Po për atë kohë ishte shumë i madh. Prapa këtyre tetë vetave qëndronin me qindra fshatarë të tjerë, që ishin të gatshëm të bënin çdo gjë që do t'u thoshte partia...»

Vasilika Demiri, e para vajzë anëtare e celulës së partisë për fshatrat Boboshticë — Drenovë — Ravonik, duke kujtuar ato ditë të largëta, po të paharruara, tregon:

«Todon e njihnin të gjithë në fshat si një komunist të vendosur dhe kishim besim të madh te ai, jo vetëm ne, të rinjtë, po edhe pleqtë. Pasi kisha marrë pjesë në disa aksione lokale, një ditë Todua më tha se do të bëhej mbledhja e celulës, që të pranohesha edhe unë në parti...»

—Todo, — i thashë, — unë jam një vajzë fshatare dhe nuk di shumë gjëra për jetën e për botën. Pa mendohu njëherë mirë...

—S'do të thotë gjë që nuk di shumë gjëra, —m'u përgjegj ai. — Celula e partisë do të jetë edhe për ty shkolla më e madhe e jetës. Pastaj, a nuk di ti se armiku vetëm me pushkë e me luftë do të shporet nga vatani? Epo, ja, kjo është kryesorja...

Todua, si sekretar i celulës, përveç të tjerave, na ngarkonte si detyrë të rëndësishme të gjenim e të grumbullonim armë të çdo lloji: pushkë, revole, bomba dore, etj... «Lufta do të jetë e ashpër dhe e gjatë, — na thoshte. — Ndaj çdo lloj arme do të na hyjë në punë...»

Meqenëse detyrën e tij si sekretar i celulës së tre fshatrave e kishte kryer më së miri, aty nga mesi i vitit 1942, shokët e Komitetit Qarkor të Par-

tisë për Korçën i komunikuan detyrën e re: ai ngarkohej me punën e fshatit për gjithë qarkun e Korçës. Tani s'kishte më të bënte me tre fshatra, po me të gjitha fshatrat e qarkut. Ai lëvizte nga fshati në fshat, në teritorin e gjerë të qarkut të Korçës. Ku e zinte mëngjezi, s'e zinte mbrëmja. Sot e shihje në fshatrat e Devollit, ditën tjetër kalonte në malësi të Voskopojës e pas ca ditësh në fshatrat e fushës...

Më 5 shtator 1942, Todua u kthye në Boboshticë. Armiku, që e ndiqte hap pas hapi prej kohësh, kishte vendosur të qëronte hesapet «me këtë komunist të rrezikshëm», siç e quante. Natën u dërguan për në Boboshticë karabinierë dhe agjentë të policisë së fshehtë italiane për ta arrestuar me çdo kusht. Ata rrethuan lagjen dhe shtëpinë e tij. Ishin qind për qind të sigurtë se këtë radhë nuk do t'u shpëtonte nga dora.

Hynë në shtëpi, nuk lanë vend pa shikuar e kontrolluar, po «komunistin e rrezikshëm» nuk e gjetën dhe u kthyen në Korçë duarbosh. Shokët e Partisë e kishin lajmëruar Todon më parë dhe ai kishte mundur të largohej nga shtëpia, para se të arrinin atje forcat fashiste. Shtëpia e Todos u bastis edhe disa herë të tjera, po gjithnjë pa sukses. Kur e kërkonin në Boboshticë, Todua gjendej në Korçë.

«Më vjen për të qeshur, — thotë vetë Todua, —kur mendoj se dy tri herë që më kërkuan në shtëpi, unë ndodhesha në një bazë të sigurtë që gjendej në qendër të Korçës, mu pranë karabinierisë. Kjo tregonte fare mirë se armiku nuk i zbulonte dot komunistët, se ata i donte dhe i ruante populli. Kjo ishte e gjitha...»

Nuk kaloi shumë kohë dhe Todon e lajmëruan

të paraqitej urgjentisht në bazën e Komitetit Qarkor. Ishte e qartë se do të kishin ndonjë punë me rëndësi...

Në vëllimin e parë të Veprave të shokut Enver, në një letër që i drejtohet Komitetit Qarkor të Korçës në prill të vitit 1943, midis të tjerave lexojmë: «...Për punën e ndërrimit të shokëve, t'i fshini buzët, keni boll elementë, sa të punoni mirë vetë dhe të ndihni edhe krahinat e tjera. Shkurt, Todo Mançon e nisni sa më shpejt për në Vlorë me anën e Skraparit e të Mallakastrës».

Ja përse e kishin thirrur Todon me ngutësi në bazën e Komitetit Qarkor të Partisë. Dhe ushtari besnik i partisë hodhi pushkën krahëve e u nis për në rrethin e Vlorës. Nga çeta në çetë e nga fshati në fshat, kaloi zona të çliruara e të paçliruara dhe, pasi la prapa Gorën, Tomoricën e Mallakastrën, arriti në fund në Vjosë. Lumi ishte fryrë dhe turbulluar nga shirat e shumta të pranverës. Todua bashkë me disa partizanë të qarkut të Vlorës formuan një zinxhir të fortë dhe e kapërcyen lumin pa pësuar gjë.

Todua s'kishte qenë asnjëherë në viset e Vlorës, po, megjithatë, atje e ndjente veten si në shtëpi të vet. Në çdo fshat që shkonte takohej me partizanë vlonjatë, dhe miqësohej shpejt me ta. Nga të katër anët jehonte kënga partizane. Zemra e tij gufonte nga gëzimi kur shihte zona të gjera të çliruara dhe besimin e patundur të njerëzve në fitoren përfundimtare...

Tani le të dëgjojmë nga vetë goja e Todos një ngjarje të vogël, po shumë interesante që i ndodhi ato ditë.

«Kur hodhëm Vjosën dhe kaluam në fshatrat e Vlorës, më ndodhi diçka, që nuk do ta harroj sa të jem gjallë — kallëzon Todua. — Kanë kaluar më shumë se njëzet e pesë vjet qysh atëhere, po mua më duket sikur ka ndodhur dje. Ishin ditët e paharruara të pranverës së vitit 1943, kur flaka e luftës partizane po përhapej me shpejtësi në të gjitha anët. Në Vlorë bëhej një luftë e ashpër kundër pushtuesve të huaj edhe kundër fraksionit të Xhepit. Një natë, bashkë me disa shokë të tjerë, ramë në një shtëpi në fshatin Isoverdh. Pasi biseduam me të zotin e shtëpisë gjerë e gjatë dhe hangrëm darkë, ramë për të fjetur. Para se të na zinte gjumi mirë, dëgjuam hapa në rrugë dhe të trokitura te dera e shtëpisë. Po nuk na bëri ndonjë përshtypje të madhe, sepse e dinim që shtëpia ishte një nga bazat më të sigurta të lëvizjes në ato fshatra. Në atë shtëpi hynin e dilnin ditë e natë edhe shokë nga reparte partizane, edhe nga ata të terrenit. . .

Pas ndonjë ore, kur mua më kishte zënë gjumi, erdhi një shok e më tha: «Ngrehu, Todo, ngrehu shpejt. Ka ardhur një shok nga Komiteti Qendror i Partisë dhe kërkon të bisedojë me ty». «Të bisedojë me mua?!» u çudita unë, po u hodha menjëherë në këmbë. Duke fërkuar sytë, desha të zbrisja poshtë në hashef që të laja fytyrën: «S'është nevoja, o derbardhë», — më tha ai që më ngriti nga gjumi. Të dy së bashku kaluam në kthinën tjetër, që ishte dhoma e zjarrit. Nën dritën e zbetë të kandilit me vajguri pashë një burrë me trup të gjatë e të lidhur, që dukej mjaft i ri. Burri i gjatë u ngrit menjëherë më këmbë dhe u përqaftuam parti-

zance, sikur të njiheshim prej një kohe të gjatë. «Ulu, Todo, ulu, — më tha me një përzemërsi që të bënte për vete. — Të thirra tani, se dua të bisedoj pak me ty; nesër në mëngjez do të nisem herët, ndaj të zgjova nga gjumi. Besoj se do të më kup-tosh...» Unë s'gjeja dot fjalë që t'i përgjigjesha. Po ai dinte si ta shtronte e ta drejtonte mirë e bukur bisedën. Dhe biseduam mjaft atë natë. Ai më pyeste për gjëra të ndryshme në lidhje me gjendjen e lëvizjes në Korçë dhe unë i përgjigjesha për ato që dija. Pastaj më foli për punën që do të bëja në rrethin e Vlorës. Me kaq biseda jonë mori fund. Para se të ndaheshim, u përqaftuam edhe një herë. Unë nuk dija kush ishte ai me të cilin bisedova. Për mua mjaftonte që dija se ai ishte një anëtar i Komitetit Qendror të Partisë.

Kishte kaluar shumë kohë nga ky takim, kur na lajmëruan se do të kishim një mbledhje me udhëheqsin e dashur të partisë sonë, shokun Enver Hoxha. Sapo doli ai në sallë, unë belbëzova si me vete, i çuditur: «Po unë e kam parë shokun Enver dhe kam biseduar me të!» Dhe m'u kujtua ajo natë e paharruar, kur, pa e ditur, kisha biseduar shtruar me Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë, shokun Enver Hoxha...»

Todua qendroi në qarkun e Vlorës afro një vit. Në fillim punoi për një kohë me organizatat e partisë në qytetin e Vlorës. Gjatë kësaj periudhe jetoi si ilegal. Përvoja që kishte fituar në Korçë, ku kish jetuar për një kohë të gjatë në ilegalitet, i vlejti shumë edhe në Vlorë. Nëpër shtëpitë e ulta e të varfëra të punëtorëve e të njerëzve të tjerë të popullit, Todua gjente ngro-



htësi, mikpritje dhe i dukej sikur ishte në shtëpi të vet. «Njerëzit që fitojnë bukën me djersën e ballit, janë kudo njëlloj, —thoshte me vete. — Ja, edhe këtu në Vlorë po ajo varfëri e po ajo skamje si edhe në Korçë. Po sa njerëz të mirë gjen këtu! Dhe sa të vendosur janë për çështjen e partisë e për çlirimin e plotë të vendit...».

Në qytetin e Vlorës Todua nuk punoi gjatë. Komiteti Qarkor i Vlorës e dërgoi me punë në Komitetin e Partisë së rajonit të Mesaplikut. Në këtë mënyrë i jepej mundësia të njihej mirë edhe me fshatarësinë e rrethit të Vlorës, që ishte lidhur me mish e me shpirt me Lëvizjen nacional—çlirimtare.

Todua qëndroi e punoi afro një vit në Qarkun e Vlorës. Ai u njoh shpejt me shokët dhe me terrenin e Vlorës dhe punoi me gjithë shpirt atje ku kish më shumë nevojë partia, atje ku e dërgonte Komiteti Qarkor i Vlorës. Si njeri i thjeshtë, ai u njoh shpejt me fshatarët e Labërisë dhe u bë mik me ta.

Lufta çlirimtare e popullit tonë po merrte përpjestime gjithnjë më të mëdha e përhapej kudo si një flakadan i papërmbajtur. Edhe në rrethin e Vlorës çetat po ktheheshin në batalione dhe batalionet në brigada. Prandaj Todua kaloi nga terreni në repartet partizane: në fillim në batalionin «Ismail Qemali» dhe pak më vonë në radhët e Brigatës V Sulmuese. Në këtë brigadë qëndroi gjer në pranverë të vitit 1944, kur mori urdhër të kthehej përsëri në qarkun e Korçës.

Kështu pra, pas një qëndrimi prej një viti në

rrethin e Vlorës, ushtari i partisë hodhi përsëri pushkën në krahë dhe mori rrugën e kthimit. Kaloi përsëri nëpër ato fshatra nga kishte qenë një vit më parë. Duke udhëtuar, vinte re çdo gjë. Ç'ndryshime të mëdha brenda një viti! Zonat e lira qenë zgjeruar shumë dhe në shumë vise arrinin gjer në afërsitë e qyteteve. Tani nuk takonte më rrugës çeta të vogla partizane, po batalione dhe brigada, që e sulmonin armikun në strofkat e tij të fundit. Në ato male e në ato fshatra kishte kaluar si një tufan i egër operacioni i dimrit i naziballistëve. Tani nuk shikonte vetëm ndonjë shtëpi të djegur aty - këtu, siç kishte parë para një viti, po fshatra të tëra të rrafshuara për tokë. Këto shkatërrime, që kishte lënë prapa armiku barbar, shtonin flakën e urrejtjes në shpirtin e tij. Në çdo hap që bënte, ai vinte re se urrejtja e popullit kundër armikut ishte shtuar shumë, ashtu siç ishte shtuar dhe vendosmëria për të arritur me çdo kusht fitoren e madhe përfundimtare.

Një natë të kthjellët pranvere, Todua kaptoi Moravën dhe ju afrua fshatit të lindjes. Fshati dukej sikur flinte: asgjë s'pipëtinte, asnjë dritë nuk dukej nëpër dritaret e shtëpive. Ai qëndroi një çast dhe vështroi vendet e njohura ku lozte kur ishte fëmijë, vështroi rrugët e fshatit. Bëri disa hapa përpara e qëndroi përsëri. Një sy vigjilent ndiqte çdo lëvizje të tij. Dhe kur ai bëri të futej në rrugën e parë të fshatit, një zë i fortë u dëgjua në qetësinë e natës:

— Ndal!

Todua dyshoi për një çast se mos ishin armiq,

prandaj zuri një vend prapa një muri të rrëzuar për gjysmë dhe u bë gati për luftë.

—Duart lart!— u dëgjua përsëri zëri.

«Duart lart, por unë jam partizan, byrazer» — tha me vete Todua dhe bëri gadi pushkën. Mirëpo në çastin e fundit u ndal. «Ata mund të jenë rojet e fshatit», — tha me vete. Dhe me të vërtetë ashtu doli, ata ishin anëtarë të rinisë, që ruanin fshatin nga sulmet e befasishme të gjermanëve e të ballistëve.

— Mbrëmë kanë bastisur shtëpinë tënde, — i tha përgjegjësi i rojeve.

— Shtëpinë time ?

— Po, ishte përhapur fjala se ti ishe kthyer nga Vlora dhe ata erdhën natën...

Todua vuri buzën në gaz dhe u nis për në shtëpi. Trokiti te dera. Asnjë përgjigje. Trokiti përsëri, po përsëri heshtje. Trokiti për së treti më me forcë. Nga brenda u dëgjua një zë gruaje : «Ikni ! Ikni nga shtëpia. Todua s'është këtu. Shkoni ta gjeni atje ku është : në mal !»

— Jam unë Todua, moj nëno, Todua ! Hape derën !

Llozi i derës u hoq menjëherë dhe e ëma, duke e përçafuar, i tha me mallëngjim :

— Djalë i nënës ! Të marsha të keqen ! Mbrëmë erdhën ata lugetër që të të kapnin. Unë kujtova se ishin përsëri ata...

— Ata vinë gjithnjë kur s'jam unë këtu, — i tha duke qeshur Todua.

— Pika që s'u bie.

— Tani po u vjen fundi. Hiç mos ki merak.

— Të na rroni ju, trimat e nënës ! — tha e ëma

dhe bëri që ta përfaqonte për së dyti.

—E di si është puna, nëno? Mos m'u afro shumë, se do të mbushesh me morra.

—Me morra? Punë e madhe! Eja të shkojmë brenda tani që të lahesh e të ndërrohesh. Ju qëroni fashistët, pa morrat i qërojmë ne, plakat.

Ndërsa shkonte poshtë e lart në shtëpi për të përgatitur darkën, e ëma herë-herë qëndronte për të vështruar të birin. Këtë radhë, me ato mustaqe të zeza që kishte lënë, e me atë trup të lidhur, i dukej më i fortë e më i matur se herët e tjera. Kish vetëm një vit që s'e kishte parë, po i dukej sikur djali ishte rritur shumë dhe i jepte përshtypjen e një burri të pjekur.

Todua qëndroi vetëm një natë në shtëpi. Të nesërmen u nis për në shtabin e zonës, ku u takua me shokët e Komitetit Qarkor të Partisë. Pas dytri ditësh, filloi përsëri punën e propagandistit dhe të agjitorit. Duke kaluar nga fshati në fshat e nga kasollja në kasolle, çonte kudo fjalën e partisë, fjalën e së vërtetës.

Në kushtet e Luftës nacional - çlirimtare, puna në teren nuk ishte vetëm e lodhshme, po edhe me rreziqe të mëdha. Detyra e kërkonte që të ishte gjithnjë në lëvizje. Për të kaluar nga një krahinë në tjetrën detyrohej të kapërcente nëpër xhade e nëpër rrugë që i ruante armiku. Shumë herë i duhej të futej nëpër vende ende të paçliruara e të punonte nën hundën e armikut.

Në gusht të 1944, Todua, duke ju afruar një fshati që gjendej pranë rrugës, ra në një pritë gjermane. Fashistët i ranë në befasi. Ai ishte fill i vetëm. Plumbat e mitralozit gjerman vërshëllenin

rreth tij. Ai u shtri menjëherë përtokë dhe ju përgjegj zjarrit me zjarr. Përlëshja vazhdoi mjaft. Befas Todua ndjeu sikur e pickoi një grenzë në këmbë. Vuri dorën dhe dora ju bë me gjak. Duke luftuar me armë, mundi të tërhiqej dhe, në errësirën e natës, të gjente rrugën e fshatit. Plaga i dhimbe dhe gjaku i rridhte rrëke. Qendroi në një vend dhe e lidhi plagën vetë. Një fshatar që e takoi rrugës, e mori në shtëpi. Ditën tjetër e dërgoi në spitalin partizan të Dardhës. Mjeku i spitalit pa se plaga ishte e rëndë dhe e shtroi menjëherë.

Në spitalin partizan të Dardhës, Todua qëndroi gati dy muaj. Po afrohej vjeshta e paharruar e vitit 1944, kur liria po bëhej gati të zbrishte nga malet nëpër qytetet e Shqipërisë. Rrugën nga do të kalonte ajo, e hapnin partizanët. Komunikatat e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë nacional-çlirimtare bënë fjalë për sulmin e përgjithshëm të forcave partizane kundër armikut. Përditë çliroheshin qytete dhe krahina të tëra. Armikut gjakatar i kishte ardhur çasti i vdekjes. Për popullin po agonte dita e madhe e lirisë; për të cilën ai kishte derdhur shumë gjak.

Në këto rrethana, Todua e ndjente mirë se ai duhej të ishte në vijë të parë të frontit. Dhe një ditë u paraqit te mjeku i spitalit partizan dhe i tha:

—Doktor, unë nesër do të dal nga spitali.

—Në asnjë mënyrë, — ja preu shkurt mjeku dhe, pasi e vështroi me ngulm, shtoi:

—A nuk shikon se plaga nuk të është mbyllur ende? Apo do të mbetesh për gjithë jetën sakat?

— Domethënë rrezik vdekje nuk ka...

Mjeku vuri buzën në gaz. Nga fjalët e të plagosurit kishte kuptuar se do ta kishte zor ta bindte që të qëndronte më shumë në spital. Po detyra e tij e kërkonte që të bënte edhe përpjekjen e fundit, prandaj nisi t'i shpjegonte se plaga e pambyllur nuk duhej të lëndohej në asnjë mënyrë, gjer sa të shërohej fare.

— Për sa ditë mendon ti, doktor, se mund të shërohet plaga ime? — e ndërpreu Todua.

— Për nja dy - tri javë...

— Aha, e ke me javë ti, doktor! Po unë s'mund të qëndroj më këtu. Është e pamundur. Duhet të më kuptosh, doktor. Këto janë ditë vendimtare...

Mjeku i spitalit partizan, kur pa se s'mund t'ja kthente mendjen, ja lidhi plagën mirë, e porositi që të mos e lëndonte gjatë rrugës dhe e lejoi të dilte nga spitali.

Një ditë të vrerët vjeshte, Todua doli nga spitali i Dardhës dhe mori rrugën e qytetit. Pushkën e kishte kaluar krahëve e në dorë mbante një shkop. Ecte me vështirësi e duke çaluar. Në të dalë të fshatit u bashkua me disa partizanë të tjerë që shkonin edhe ata për në qytet. Tanimë nuk e ndjente dhe aq shumë dhembjen e plagës. Duke ecur, bisedonin për ngjarjet e ditëve të fundit dhe për çlirimin e afërt të Shqipërisë. Herë - herë pushonin së foluri dhe ecnin si të menduar. Ata me siguri bënë plane të reja për kohën e re që po fillonte. Edhe Todua, megjithëse ende kishte dhëmbje dhe ecte çalë - çalë, ndjente në shpirt një forcë të re e një vrull të ri për detyrat e reja që do t'i ngarkonte partia. Ashtu si gjatë luftës së armatosur që po merrte

fund, ai edhe tani do të kërkonte të shkonte në frontin më të vështirë të punës, atje ku do të kërkohej më shumë mund e djersë...

## V. BUSULLA E JETËS

Todua mbriti në Korçë bashkë me forcat partizane që e çliruan. Qyteti ishte në festë. Nga të katër anët jehonte kënga partizane...

Todua, që kishte jetuar për një kohë si ilegal në këtë qytet, tani dilte rrugëve lirisht, takohej me shokët dhe merrte pjesë edhe vetë në festën e madhe popullore. Po lufta vazhdonte në shumë anë të vendit. Shqipëria nuk ishte çliruar ende plotësisht. Ushtria nacional-çlirimtare, duke ndjekur armikun këmba këmbës, i jepte goditjet e fundit.

Todua u fut edhe njëherë në radhët e ushtrisë. Bashkë me forcat e Brigadës IX Sulmuese, në të cilën qe caktuar si përgjegjës i agjitacionit dhe i propagandës, ai kaloi nga Jugu në Veri. Çlirimi i plotë i vendit e gjeti në rrethin e Krujës.

Në atë kohë u bë një riorganizim në forcat armatosura dhe Todua u transferua në repartet e mbrojtjes së popullit. Për një kohë ai mori pjesë në pastrimin e disa krahinave malore të Shqipërisë së Veriut nga mbeturinat e bandave reaksionare.

Tani Shqipëria hynte në një fazë të re të historisë së saj. Nga të katër anët e vendit po fillonte puna për hedhjen e themeleve të ekonomisë së re popullore. Populli i çliruar, duke punuar me vrull për të shëruar plagët e thella të shkaktuara nga armiku gjatë luftës, gatitej për rrugën e gjatë e të vështirë të ndërtimit të bazave të socializmit.

Për këtë arsye, shumë kuadro të luftës kalonin nga forcat e armatosura, në sektorët e ndryshëm të ekonomisë popullore.

Todua, kur e pyetën se ku dëshironte të punonte, zgjodhi sektorin e minierave. Ai vinte nga bankat e shkollës dhe nuk kishte punuar asnjëherë në ndonjë minierë. Atëhere përse zgjodhi si front pune atë të minierave? Përgjigjen për këtë le ta japë vetë ai:

«As unë s'e di mirë se si më kishte lindur një dëshirë e madhe që të punoja në minierë. Që kur isha i vogël kisha dëgjuar të flitej për punën e rëndë të minatorëve në minierën Mborje-Drenovë, që nuk është larg nga fshati im. Nga këto biseda ndjeja një admirim të madh për ata burra të fortë, që futeshin në thellësi të tokës për të nxjerrë së andejmi qymyr. Pastaj erdhi lufta që m'i thithi të gjitha mendimet dhe të gjitha energjitë. Po, në prakun e çlirimit dhe menjëherë pas çlirimit, bisedoja shpesh me shokët për punën që do të bënim në Shqipërinë e lirë. Midis shokëve kishte dhe asish që thurnin plane dhe ëndërra që të bëheshin aviatorë e të fluturonin lart në qiell. Unë i dëgjoja me vëmendje, pastaj u thosha: «Mirë e keni, s'e keni keq. Po, që të fluturosh lart në qiell, duhet të futesh njëherë në thellësitë e tokës, sepse, pa minerale, s'mund të kesh mjete për të fluturuar...». Edhe atyreve që ëndërronin të bëheshin inxhinierë apo teknikë nëpër fabrikat, që do të ndërtoheshin te ne, unë u thosha: «Pa mineralet, që nxirren nga thellësia e tokës, s'mund të bëhen as fabrika». Kështu pra, kalova në sektorin e minierave. Po në çdo sektor, e në mënyrë



të veçantë në atë të minierave, që është i vështirë sa edhe i ndërlikuar, nuk mjafton vetëm dëshira e mirë që të japësh atë që duhet; duhet edhe dituria, shkenca. Ndërsa unë atëhere s'kisha asnjë përgatitje për punën e minierave... Brezit që kishte bërë Luftën nacional - çlirimtare, i dilte tani një kala tjetër për ta marrë: ajo e shkencës më të përparuar. Po edhe kjo kala do të merrej. Dhe do të merrej me sulm, brenda një kohe të shkurtër... Në atë kohë, partia dërgoi shumë kuadro për të studjuar jashtë shtetit. Mua më dërgoi në Universitetin e Krakovisë, në Poloni, në fakultetin e inxhinierisë minerale. Kishte ardhur një epokë e re, kishte ardhur koha e Partisë, kur ëndërrat dhe dëshirat e të rinjve bëheshin realitet...»

Në Universitetin e Krakovisë, Todua vazhdoi studimet për katër vjet. Praktikën e bëri në minierat e qymyrit të Polonisë. Atje vinte re çdo gjë. Me një vëmendje të veçantë ndiqte mekanizimin e punës nëpër miniera. Ai e kishte të qartë të ardhmen e vendit tonë. Në Shqipërinë e re, minierat do të merrnin një zhvillim të madh, të jashtëzakonshëm. Ndaj do të nevojitej një punë e madhe dhe e vështirë për mekanizimin e minierave që ekzistonin dhe të atyreve që do të hapeshin...

Në verë të vitit 1952, Todua u kthye në atdhe me diplomën e inxhinierit në xhëp dhe me entuziazmin e rinisë në zemër. Dëshira e tij më e madhe ishte të fillonte sa më parë nga puna në ndonjë minierë. E caktuan si inxhinier miniere në Rubik. U nis menjëherë për në vendin e punës.

Më në fund kishte ardhur koha që të vinte në jetë ato që kishte mësuar me këmbëngulje në shkollë...

Viti 1952. Puna për realizimin e planit të parë pesëvjeçar ishte ende në fillim. Shumë nga minierat më të rëndësishme të vendit, që sot janë mburrja e industrisë sonë minerale, asokohe nuk ishin zbuluar ende. Disa të tjera ishin në hapat e tyre të para. Rubiku, një nga minierat më të vjetra të vendit, luante një rol të rëndësishëm për zbulimin dhe zhvillimin e minierave të reja të Veriut. Minatorët e vjetër me të drejtë e quajnë Rubikun «nëna e minierave». Këtej u nisën minatorët e parë, që vajtën në Bulqizë. Këtej u nisën edhe për Kurbnesh, edhe për Spaç, edhe për Tus. Madje në atë kohë, disa nga minierat e reja vareshin drejtpërsëdrejti nga Rubiku. Ndaj inxhinjeri i ri, që sapo kishte lënë bankat e universitetit, kishte një teren shumë të gjerë për të vepruar. Dhe ai ju përvesh punës me këmbëngulje partizane dhe entuziazëm rinor.

Në minierën e bakrit të Rubikut vështirësitë e shfrytëzimit të mineralit shtoheshin përditë më shumë. Midis gjeologëve kishte mendime se rezervat e bakrit në atë minierë gati po shteronin. Inxhinjerit të ri i duhej të tregonte një interesim të veçantë për zhvillimin e sektorëve të rinj dhe të minierave të reja. Duke kaluar nga galeria në galeri e nga sektori në sektor, ai takohej me minatorë e me teknikë të vjetër, dëgjonte mendimet e propozimet e tyre, pastaj luftonte që ato të vihejshin në jetë.

Disa shokë të minierës, duke e parë Todon

gjithnjë në lëvizje, thoshin me vete: «Ky është entuziazmi i fillimit të një të riu. Me kalimin e kohës, ky entuziazëm bie, dobësohet». Po javët e muajt kalonin dhe ata shikonin të kundërtën. Inxhinjeri i ri bëhej përditë më sistematik në punën e tij, pa humbur aspak vrullin dhe entuziazmin i ditëve të para. Ata u detyruan të ndërrojnë mendim. Miniatorët, nga ana e tyre, duke e parë gjithnjë pranë, filluan ta duan. Ata e shikonin Todon si një shok të tyre të ngushtë, që nuk dinte vetëm t'u jipte udhëzime dhe porosi, po dhe të mësonte nga përvoja e tyre e pasur.

Mirëpo Todon nuk e lanë për një kohë të gjatë në minierën e Rubikut. Pesëvjeçari i parë po realizohej e po tejkalohesh. Minierat e vjetra zhvilloheshin me shpejtësi. Minierat e reja zbuloheshin e viheshin në shfrytëzim në vendet më të largëta e më të humbura të vendit. Përveç luftës në bazë, duhej edhe një punë organizative dhe administrative në qendër. Për këtë punë nevojiteshin njerëz të zotë, njerëz që të kishin edhe përgatitje teorike, edhe përvojë praktike nga baza. Në gusht të vitit 1954, Todua transferohet nga Rubiku në Tiranë dhe emërohet drejtor i drejtorisë së minierave pranë Ministrisë së Industrisë.

Kur e thirrën në qendër që t'i njoftonin transferimin dhe gradimin në një post më të lartë, ai u tha: «Nuk është punë për mua kjo. Nuk do të mund ta kryej ashtu si duhet. Se nuk e kam aspak me qejf. Unë jam për në minierë. Miniera është pasioni im. Më dërgoni ku të doni, në çdo minierë që të keni nevojë, po jo në qendër, në ministri...»

Kërkesa e Todos nuk u muarr parasysh. Kështu

ai la Rubikun e vajti në Tiranë. Më vonë, kur e pyetën disa shokë të ngushtë, pse pranoi të shkonte në një punë që nuk i pëlqente, ai u përgjegj:

«Busulla ime në jetë është kjo: të bëj ashtu siç thotë partia në çdo kohë e në çdo rrethanë, të vë në jetë kudo e kurdoherë porositë dhe mësimet e saj...»

## VI. UNIVERSITETI I PRAKTIKËS

Todua qendroi në ministri si drejtor i drejtorisë së minierave vetëm disa muaj. Për këtë periudhë të aktivitetit të tij nuk dihen shumë hollësi. Nëse ai flet pak për punën e tij në përgjithësi, për atë kohë nuk flet fare. Shokët e tij më të ngushtë thonë: «Vetëm njëherë hapi gojën e foli për punën e tij në ministri. Po edhe atëherë tha vetëm kaq: «Për mua kjo ka qenë periudha më e varfër e jetës sime».

Ata që e kanë njohur qysh në atë kohë, thonë se Todon shumë rrallë mund ta gjeje në zyrë. Pjesën më të madhe të kohës e kalonte në minierat e reja, që kishin më shumë nevojë për ndihmë. Ai vizitoi një pjesë të mirë të këtyre minierave. Madje, nga sa thotë ai vetë, i ka mbetur peng që nuk e ka shfrytëzuar mirë kohën që të shkonte në të gjitha minierat e vendit, pa përjashtim.

Nga kjo del se ai punën operative në minierat e reja e kryente mirë, po puna e drejtimit, e studimit dhe e përgjithësimit të përvojës së minierave të përparuara çalonte shumë. Todua e shikonte vetë këtë dobësi të tij dhe gjithnjë bënte kërkesa të reja për t'u larguar nga ministria.

Një ditë e thirrën dhe i komunikuan transfe-

rimin në minierën e Bulqizës. Kërkesa e tij për t'u kthyer në bazë ishte marrë parasysh. Vetë jeta kishte treguar se Todua nuk ishte në vendin që i përshtatej.

Kjo ishte një ditë e paharruar për Todon. Ai e dinte se Bulqiza ishte një minierë e re, me probleme të mëdha e të vështira, po «aq më mirë për mua, — thoshte me vete Todua. — Atje do të kem mundësi të heq nga vetja këtë amulli, që më ka kapulluar, edhe t'ja shpërblej partisë për punën jo shumë të frutëshme që kam bërë në ministri.»

Atij që do ta zëvendësonte në drejtorinë e minierave, i tha haptazi: «Se sa i varfër është bilanci i punës sime këtu, në ministri, do ta shikosh tani gjatë dorëzimit të çështjeve të drejtorisë. Sipas regullores puna e dorëzimit mund të zgjasi disa ditë. Po unë, or vëlla, s'kam shumë gjëra për të dorëzuar. Me shumë probleme as që jam marrë fare. Kam vetëm një dosje me raporte dhe akte kontrolli nga inspektimi i disa minierave...»

Puna e dorëzimit mori fund shpejt dhe Todua u nis menjëherë për në Bulqizë, ku do të punonte si kryeinxhinier i minierës më të madhe të kromit në vendin tonë...

Ishte prilli i vitit 1955. Populli përpiqej që ta mbyllte me sukses planin e parë pesëvjeçar. Partia përgatiste planin e dytë pesëvjeçar; sipas këtij plani, minierat në përgjithësi do të merrnin një zhvillim të madh. Në mënyrë të veçantë nxjerrja e kromit do të shtohet me një ritëm shumë të shpejtë. Prandaj kuadrove të minierave dhe gjithë kolektivit u dërgonin përpara shumë detyra.

Kur mbriti Todua në Bulqizë, miniera gjen-dej përballë problemeve të mëdha. Që të realizohej plani i dytë pesëvjeçar në nxjerrjen e kromit duhej të mekanizoheshin punët kryesore brënda në galeritë. Duhej të organizohej mirë puna e seleksionimit, para se të nisej minerali për eksport. Transporti i kromit kishte nevojë për një studim të veçantë. Po, mbi të gjitha, shtohet detyra e madhe që të punohej me kolektivin e minatorëve, që në shpatullat e tyre të forta të mbanin gjithë punën e minierës.

Kanë kaluar afro pësëmbëdhjetë vjet qysh atëhere. Dy plane pesëvjeçare janë realizuar e tejkaluar dhe një tjetër po realizohet tani me sukses të plotë. Bulqiza është bërë një nga minierat më të mëdha të kromit në botë. Të gjitha manualët e librat e statistikave flasin për të si për një minierë që zë vendin e katërt a të pestë në botë. Gjatë kësaj periudhe prej tre planesh pesëvjeçare, Todo Mançua, si kryeinxhinier i minierës, ka shkruar të gjitha energjitë e tij që miniera të shkojë gjithënjë përpara. Po ta pyesësh se ç'i ka dhënë minierës gjatë kësaj periudhe jo të shkurtër, ai të shikon njëherë si me habi dhe të thotë:

«Pse e shtroni kështu problemin? Ju më pyesni se ç'i kam dhënë unë minierës gjatë këtyre tre pesëvjeçarëve që shërbej në Bulqizë. Po unë do të kisha qejf t'ju flisja më mirë për ato që kam marrë, për ato që kam mësuar këtu. E pra, miniera për mua ka qenë dhe vazhdon të jetë gjithnjë një burim i pashtershëm dije dhe përvoja, që s'mund t'i gjesh në asnjë libër, në asnjë manual dhe në asnjë revistë. Qysh ditën e parë që mbrita

këtu, m'u duk sikur kisha hyrë në një universitet të klasit të parë, në universitetin e madh të praktikës. Në këtë universitet vazhdoj të jem edhe sot dhe me dëshirën time, nuk kam për t'u larguar kurrë, gjersa do të jem në gjendje të punoj...»

## VII. AI DHE KOLEKTIVI

Është e natyrshme që çdo njeri, kur shkon me një punë në një vend të ri, apo në një qendër pune të re, do të përpiqet të njihet me ambientin në të cilin do të jetojë e do të punojë. Todua u njoh shumë shpejt me problemet e minierës së Bulqizës, që ishte në zhvillim të pandërprerë. Këto probleme ishin të mëdha dhe të vështira. Ato ishin edhe probleme, që kërkonin një zgjidhje të menjëhershme, edhe probleme që kishin të bënin me zhvillimin dhe zgjerimin e minierës në të ardhmen. Si duhej të vepronte ai për zgjidhjen e tyre?

Puna e parë që bëri kryeinxhinieri i ri i minierës, ishte që të njihet mirë me kolektivin, e në radhë të parë me minatorët. Ai u njoh me ta edhe gjatë punës, edhe jashtë punës. Ai zbriste përditë në galeri bashkë me minatorët. Dhe bisedonte me ta si mik, si shok. Edhe pas mbarimit të punës nuk ndahej nga minatorët. Me ta shkonte në klub, me ta dilte shetitje e me ta ndante gëzimet e hidhërimet e jetës në këtë qytezë të largët, që po lindte në mes të maleve.

Pasi u njoh mirë me ta, u bind se të gjitha problemet, sado të mëdha e të vështira që të ishin, do të zgjidheshin me sukses. «Me këtë kolektiv të

mrekullueshëm, me këta minatorë që s'u trembet syri nga asgjë, mund të përmbysësh edhe malet»— i pëlqen Todos të përsëritë shpesh, kur flet për rrugën që ka bërë miniera, në luftë me një mijë mungesa e vështirësi.

Nga ana e tyre, minatorët kanë shumë gjëra për të thënë për kryeinxhinierin e tyre. Kamber Durici u shpall Hero i Punës Socialiste po atë ditë që u shpall edhe Todua. Kamberi është minatori më i vjetër në Bulqizë. Ai punonte atyre anëve si çoban, kur erdhën nga Rubiku ata që do të hapnin minierën e re. Dhe ai la kërrabën e bariut e mori kazmën e pistoletën e minatorit. Tani, po ta pyesësh për Todon, të thotë: «Po fillove të flasësh për Todon, e ke vështirë të mbarosh. Se të vinë shumë gjëra përnjëherë në mend. Nejse. Todua ka ardhur në minierën tonë këtu e trembëdhjetë - katërmëdhjetë vjet më parë. Sa mbriti këtu, kërkoi të njihej me ne, minatorët. Dhe e di ku u njoh më mirë me ne? Brenda në galeritë e minierës. Ai hyri aty bashkë me ne. Dhe punoi bashkë me ne në vijën e parë të frontit, në ballë të galerisë, si i themi ne. Unë kam vënë re se ai nuk rri asnjë ditë pa hyrë në galeri. Shpirti i tij është aty. Kur ndodh ngandonjëherë të jetë larg minierës, ai kthehet me mall dhe puna e parë që bën, është që të hyjë në galeri, të takohet me ne. Ja, kështu u njoh Todua me ne. Kështu u miqësua me kolektivin tonë. Dhe e di ç'do të thotë të miqësohesh me minatorët? Minatorët janë njerëz të fortë, të mësuar e të kalitur në vështirësitë. Dhe, po t'u hysh në zemër, ec përpara pa frikë, se miqësia e tyre është më e fortë se shkëmbi, me të cilin përleshën përditë. ...»



Edhe Beqir Xhemali është një nga veteranët e minierës së Bulqizës. Ai ka disa vjet që punon si minator dhe si brigadjer. Po ta pyesësh për Todon, të flet çiltas: «E ku ka si Todua or byrazëri! Ti e shikon kështu të veshur me kapotë të vjetër ushtarake dhe me kominoshe minatori e ndoshta s'ta mbush syrin. Po e di si themi ne minatorët? «Nën këtë veshje të thjeshtë prej minatori rreh një zemër prej revolucionari të vortetë». Po, kështu është. Kanë hakë ata që flasin kështu për Todon. Sepse ai qendron gjithnjë pranë minatorëve. Kur jemi duke punuar në ndonjë front të vështirë, ai vjen pranë nesh e punon bashkë me ne. Se ai di të përdorë të gjitha veglat e punës së minatorit. Kur ndodh ngandonjëherë që ndërpritet damari i mineralit dhe ne s'dimë nga të vazhdojmë, atëhere vjen Todua dhe na tregon rrugën, na jep zgjidhje. Se ai është si ne, po ka edhe diçka më tepër: ai di më shumë se ne...»

Pasi u njoh mirë me kolektivin dhe u shkri e u bë një me të, Todua filloi të zbatonte shumë metoda të reja për shfrytëzimin e bloqeve të kromit. Së pari zbatoi me sukses të plotë sistemin e shfrytëzimit me galeri nënkate. (Gjer në fund të vitit 1955, në minierën e Bulqizës zbatohesh sistemi i shfrytëzimit me mbushje). Ti futesh në një galeri të thellë dhe ecën në zemër të malit. Befas të del përpara një si oxhak. Atje mund të zbresësh dhe të vazhdosh rrugën në një kat tjetër të galerisë. Të gjitha këto galeri me kate e nënkate të çojnë drejt një objekti të caktuar: drejt blokut të kromit. Mali i lartë i Bulqizës të duket si i qetë dhe i heshtur nga jashtë. Po në thellësi të tij gjendet një

labirint i tërë me galeri të shumta, me nënkate të panumërta, me oxhaqe e me puse. Dhe në këtë labirint të ndërlikuar lëvizin pa pushim minatorët, që sulmojnë me pistoleta për të nxjerrë sa më shumë krom. Po ky sulm bëhet në bazë të një plani, ashtu si bëhet edhe çdo sulm në frontin e luftës. Ashtu si në luftë edhe këtu, që sulmi të ketë sukses, përpilohen harta gjeologjike e harta topografike nga njerëz të sektorëve dhe të specialiteteve të ndryshme. Po ashtu si në luftë, edhe këtu këto grumbullohen te shefi i shtabit, në rastin e minierës, te kryeinxhinieri i ndërmarrjes, i cili kombinon dhe organizon çdo veprim.

Epërsia e sistemit të çfrytëzimit me galeri nënkate dha përfundime të shkëlqyera. Rëndimenti i punës së minatorëve u shtua menjëherë, kapaciteti prodhues i minierës u zgjerua shumë dhe humbjet e mineralit, që s'mund të mënjanoheshin me sistemin e vjetër, u kufizuan shumë.

Krahas kësaj, në minierën e Bulqizës u zbatuan edhe shumë metoda të reja. Prodhimi i saj u shtua me shpejtësi dhe sot, njëzet vjet pas fillimit të punimeve, Bulqiza është bërë e njohur në të gjithë botën. Kromi i cilësisë së lartë që nxirret këtu, tashmë është i njohur në të gjitha tregjet e botës. Ai është bërë artikulli kryesor i eksportit tonë. Minatorët e Bulqizës thonë me mburrje të ligjshme se minerali i vlefshëm, që ata nxjerrin nga thellësia e nëntokës, ndihmoi që të thyhej blokada e revizionistëve kundër vendit tonë. Gjatë kësaj kohe, shumë drejtorë dhe inxhinierë kanë ardhur këtu, kanë punuar dhe janë larguar përsëri. Secili nga këta ka bërë diçka për të mirën e minierës.

Po zhvillimi i vrullshëm i kësaj miniere të dorës së parë për vendin tonë lidhet ngushtë me emrin e Todo Manços dhe të minatorëve të saj të mrekullueshëm, që punojnë ditë e natë për të nxjerrë sa më shumë krom e për të shtuar begatinë e atdheut.

### VIII. «ÇDO DITE BEHEMI MË TË MENÇUR»

Jorgo Kola punon prej shumë kohësh si kryegjeolog i minierës së Bulqizës. Nga puna që kryen, bashkëpunon përditë me kryeinxhinjerin e ndërmarrjes, Todo Mançon. Dhe ka shumë gjëra për të kallëzuar për të.

«Mendoj se është më mirë të flas vetëm për një ditë pune së bashku me të, — thotë ai. — Si gjeolog i minierës së Bulqizës, më takon shpesh të futem bashkë me Todon në labirintin e galerive, prej ku buron, si rrëke të vogla, minerali i kromit, i cili bashkohet pastaj në një lumë të madh atje te bunkerët, ku ngarkohen «Skodat». Todua gjeologët i quan «pararojë e minierës». Zjarrmëtarët, që ndezin minat, i quan «artilierë», kurse minatorët, që thërmojnë shkëmbinj dhe nxjerrin mineralin, janë për të ushtarët e këmbësisë, që i japin fund betejës me mbushjen e vagonave me krom... Një herë u nisëm së bashku për në galerinë Nr. 47 të zonës B. Jashtë binte dëborë e bënte ftohtë, kurse në galeri kishte një qetësi e një ngrohtësi të ëmbël. Atje u takuam me përgjegjësën dhe me inxhinjerin e zonës. Që të katër ecnim në galeri nën dritën e zbetë të llambave të karbitit... Së bashku me shokët e zonës kishim për të zgjidhur një problem mjaft të vështirë. Në kundërshtim me

të dhënat gjeologjike që kishim marrë prej kohësh, minatorët panë se trupi i kromit nuk vazhdonte më tutje. Kjo mund të ndodhë në çdo minierë, po ndodh sidomos me kromin, që jo vetëm gjendet në malet më të largëta, po, ashtu si themi ne gjeologët, është edhe shumë «dinak» dhe përpiqet të fshihet. Pra, ne na duhej të gjenim kromin e fshehur. Që ta zgjidhnim mirë këtë problem të vështirë kishim marrë me vete harta topografike dhe materiale të tjera rreth përfundimeve që kishte arritur kërkimi gjeologjik.

— Ç'i doni të gjitha këto harta dhe dokumenta me vete? — tha si me shaka përgjegjësi e zonës, më tepër për të shikuar se ç'do të thoshte Todua, që i kishte dalë emri se ishte kundër shkresave zyrtare.

— Kështu thua ti? — u kthye dhe i tha Todua aty për aty.

— Nuk janë burokraci këto letra e këto harta, o Todo?

— Unë kam një mendim të kundërt, — u përgjegj Todua. — Çdo gjë e shkruar e çdo dokument nuk është burokraci. Në luftë, pa harta e pa vrojttime zbulimi të hedhura në hartë, nuk mund të bësh as plane mbrojtjeje dhe as plane sulmi; dhe as që mund të jepet urdhëri i komandantit në kohën e duhur për të arritur fitoren. Edhe këtu, në thellësitë e tokës, pa këto materiale, ne do të ishim qorra dhe nuk do të arrinim ta gjenim kurrë mineralin e kromit.

U ngjitëm në një oxhak të pjerrët thikë, të armatosur me trupa. Më mirë mund të thuash kacaviremi njëri pas tjetrit me vështirësi, duke u

mbajtur pas trupave të trashë. Në një çast Todua mbetet pak prapa nesh. «U plake, shoku Todo!» — desha ta ngacmoj unë. Ai, pa u përgjegjur fare, mori një vrull, doli në krye të grupit dhe vazhdoi të ecte përpara në katin tjetër të galerisë. Unë e shikoja si me habi e admirim. Megjithëse po i afrohej të pesëdhjetave, ishte gjithnjë i shkathët, i palodhur, i gatshëm për çdo punë, sikur të që në lulën e rinisë...

Më vjen tani ndërmend një bisedë që kemi bërë njëherë pas një ngjitjeje alpinistike në zonën «D». Todua arriti i pari në vend dhe na shikonte me një buzëqeshje ironike, se po i afroheshim qendrës së zonës duke dihatur. Para se të futeshim në galeri, dikush nga ne e pyeti:

— Është e vërtetë, Todo, se nuk je sëmurrur asnjëherë në jetën tënde?

— Nuk besoj, — tha me dyshim një inxhinier, që atëherë sapo kish ardhur në minierë. — Është e pamundur.

— E vërteta është se gjer tani më ka ecur shëndeti, — tha ai, pa dashur t'i përgjigjej drejtpërsëdrejti shokut që i kishte bërë pyetjen.

— Shokët e tu më të vjetër thonë se as koka nuk të dhemb kurrë.

— Kjo nuk është e vërtetë, — tha prerazi Todua. — Koka më dhemb, dhe madje shumë, kur kam të bëj me ndonjë burokrat...

Vazhduam të ecnim brenda në galeri. Todua qëndronte gjithnjë në krye. Galeria sa vinte e ngushtohej. Po i afroheshim ballit, atje ku luftohej për nxjerrjen e kromit. Befas prapa nesh u dëgjuan hapa të nxituara. Kthejmë kokën dhe shohim

Izetin, zjarrmëtarin e sektorit. Ai shkante për të ndezur minat.

— Sa bira bëni në këtë vend? — e pyeti Todua, duke shikuar me kujdes rreth e rrotull.

— Nëndë gjer në njëmbëdhjetë, — u përgjegi zjarrmëtari.

— Po si i ngarkoni me lëndë eksplozive?

— Pesë kallëpe në mes, katër lart. . .

— Keq, shumë keq. Në këtë teren duhet vepruar ndryshe. Birat e tavanit këtu duhet të ngarkohen me tre kallëpe, madje do të thosha se duhet të bëjmë prova edhe me më pak. Ato ndizen të fundit dhe efektin e bëjnë njëlloj. Pastaj nuk duhet shkallmuar taveni i punimit mineral, se pastaj bie lehtë dhe çdo pëllëmbë vendi kërkon trupa të fortë për armaturë. Dhe ti duhet ta dish mirë, o Izet, se sa me krëk e kemi lëndën e drurit.

Zjarrmëtari e shikoi me një farë hutimi e mosbesimi. Ai ishte mësuar prej kohësh dhe nuk e kishte të lehtë të hiqte dorë nga mënyra e vjetër e veprimt.

— Të shoh se s'më beson, or byrazer. Po hajde bëjmë një provë, që ta shohim të gjithë dhe të të mbushet edhe ty mendja.

Prova u bë menjëherë. Zjarrmëtari u bind plotësisht dhe në mbrëmje, kur u takua me shokët, pasi u foli mbi ngjarjen e ditës, u tha:

— Ai nuk flet kot. Çdo gjë që thotë e peshon mirë njëherë e pastaj e nxjerr nga goja. Fjala e tij qëllon në shenjë.

Pas këtij episodi, u ngjitëm edhe njëherë dhe arritëm në vendin ku trupa e mineralit të kromit kishte pasur një ndërprerje. Kjo ishte një ga-

leri, që jepte një prodhim të madh. Parashikimet gjeologjike premtonin një blok shumë të pasur kromi. Ndërsa, në të vërtetë, trupi i kromit ndërpritej. Për këtë gjë u prekupuan menjëherë përgjegjësit e zonës, po edhe njerëzit e drejtorisë së ndërmarrjes. Një ditë më parë inxhinieri i zonës i kishte paraqitur këshillit teknik një raport verbal të hollësishëm, duke bërë edhe propozime konkrete. Sipas këtij raporti, kishim të bënim me një prishje tektonike. Ne, gjeologët, quajmë prishje tektonike disa të çara të mëdha, që pësojnë shkëmbinjtë mineralë e largohen nga njëri tjetri, kështu që vazhdimi i tyre ndërpritet, duke shkuar më poshtë, ose më lart. Inxhinieri i zonës, në raportin e tij, kish çfaqur mendimin se nuk mund të bëheshin kërkime më poshtë, po të bëhej një shembje dhe vazhdimi i mineralit të kërkohet më lart. Edhe të tjerët morën anën e inxhinierit. Pritej vetëm mendimi i Todos, për të filluar shembjen: «Mua nuk më mbushet mendja me këto që thoni ju, — nisi të thoshte Todua. — Prandaj s'mund t'i japim karar sonte kësaj pune. Nesër në mëngjez do të shkojmë vetë në galeri dhe atje do të marim vendim, në vend». Ja, pra, përse po shkonin atë ditë në ballë të galerisë. Ju afroam vendit ku kishte ndodhur ndërprerja, dhe bëmë një konsultë në këmbë. Nxorëm hartat dhe i shikuam nën dritën e zbetë të llambave të karbitit. Inxhinieri i zonës paraqiti edhe njëherë me bindje të plotë argumentat e tij. Ne nxorëm çekiçet e gjeologut dhe çukitëm me kujdes nga të gjitha anët. Todua na shikoi me vëmendje. Më në fund nxori edhe ai çekiçin e vet. Ky është në çekiç krejt orgjinal, që e ka bërë vetë

Todua dhe e merr me vete gjithënjë kur futet nëpër galeritë e minierës. Unë kam më se dhjetë vjet që punoj si gjeolog. Kam parë shumë çekiçë gjeologësh të markave e të madhësive të ndryshme, po çekiç si të Todos nuk kam parë kurrë. Todua filloj të çukiste me çekiçin e vet poshtë e lart prishjes tektonike. Këtë punë e bëri një herë, dy, tri, pesë dhe përsëri u kthye nga fillimi. Më në fund tha:

— Po, ashtu është, ashtu si thotë Baftjari. Duhet bërë një shembje, që mineralin e kromit ta kërkojmë më lart...

— Kështu de, më në fund u binde! — thirri i gëzuar inxhinieri i zonës.

— Unë nuk thashë as die se ti s'kishe të drejtë. Desha vetëm ta shikoja gjendjen në vend. Ti besoj se e di që ata të shtabit duhet ta kontrollojnë situatën nga afër para se të marrin vendim për sulm. Edhe këtu, në minierë, çdo vendim i nxituar dhe i pastudjuar na kushton shumë djersë, përveç materialeve që mund të shkojnë kot.

Pasi mbaruam punë në galeri, morëm rrugën e daljes.

— Ti, Baftjar, mos u habit nga kjo që ndodhi sot, — vazhdoi Todua. — Ne mësojmë përditë edhe nga librat, edhe nga praktika. Ndaj themi se çdo ditë bëhemi më të mënçur. Më kupton?

## IX. AI PUNOI SI VAGONIST

Miniera e Bulqizës është një ndërmarrje e madhe minerale, me shumë sektorë pune e me plan të madh për të realizuar. Këtu nxirret pjesa



më e madhe e mineralit të kromit, që eksportohet nëpër vënde të ndryshme të botës. Plotësimi ritmik i planit çdo muaj e çdo tremujor është problem i madh për gjithë vendin. Po të mos realizohet plani i nxjerrjes së kromit, nuk mund të plotësohen kontratat e eksportit, që qeveria jonë lidh me qeveri e me firma të ndryshme të huaja. Ata që punojnë prej kohe në Bulqizë, kushedi sa herë e kanë dëgjuar Todon nëpër konferenca e biseda që thotë: «Krom. A e dini se çdo të thotë krom për Republikën tonë? Krom do të thotë grurë, bukë; krom do të thotë, maqina për industrinë, traktora për bujqësinë, barna për shëndetin e popullit...» Me këto fjalë ai përpiqet të bëjë të qartë se me anë të eksportit të kromit sigurohet një pjesë e mirë e valutës. Po të jetosh në minierën e Bulqizës, qoftë edhe për një kohë të shkurtër, ke për të dëgjuar shumë biseda interesante për zhvillimin e vullshëm të industrisë sonë minerale. Nëpërmjet këtyre bisedave mund të të kapi veshi disa shifra që, kur i dëgjon për herë të parë, mund të të habitin me gjithë mend. Dhe këto shifra në gojë të këtyre punonjësve të pa lodhur të nëntokës marrin një tingull të veçantë. Kështu për shëmbull, s'ke si të mos ndjesh një kënaqësi të thellë dhe një krenari të ligjëshme kur dëgjon se Shqipëria jonë e vogël zë vendin e katërt a të pestë në botë për sa i përket sasisë vjetore të kromit që nxjerr. Po diçka më karakteristike është se vendi ynë zë tani vendin e parë në botë për sa i përket sasisë së kromit të nxjerrë për frymë të popullsisë!..

Sa përpjekje është dashur që të arrihen këto përfundime të mrekullueshme! Sa rrëke djerse janë

derdhur në thellësinë e tokës së malit të Bulqizës!  
Dhe sa djersë derdhet përditë që ky lumë i madh  
i kromit, që buron nga Bulqiza, të vërshojë pa pu-  
shim drejt vendeve të seleksionimit e drejt ske-  
lave të atdheut!

Po edhe këtu nuk shkon çdo gjë gjithnjë në  
rregull, si sahat. Ka raste që ndonjë sektor të mbetet  
prapa dhe kështu të vihet në rrezik realizimi i pla-  
nit të ndërmarrjes. Kryeinxhinieri i miniërës, që i  
kontrollon përditë të dhënat mbi realizimin e pla-  
nit nëpër sektorët e ndryshëm, merr masa e shkon  
edhe vetë atje ku puna çalon, atje ku rrezikohet  
realizimi i planit.

Kështu, përshebull, kishte kohë që një sek-  
tor i rëndësishëm i miniërës mbetej gjithnjë prapa.  
Plani nuk realizohej, transportimi i kromit nuk ec-  
te me ritmin e duhur. Dhe jo vetëm kaq, po ishin  
përhapur fjalë dhe ishin shprehur mendime se gjo-  
ja normat në disa procese pune ishin tepër të larta.  
Todua vajti në vend, e studjoi gjendjen nga afër  
dhe pa se ishte mjaft serioze. Dhe mori menjëherë  
një vendim. «U pa puna, — tha me vete. — Duhet  
të punoj vetë për disa kohë në këtë sektor». Dhe kë-  
shtu bëri. Ai u nis në mëngjez herët për në sektor  
bashkë me minatorët që punonin atje, dhe, në orën  
e caktuar, filloi nga puna. Ai u bë vagonist. Vago-  
nist jo për një orë e dy, jo «sa për sport», si i tho-  
në fjalës, po si punëtor i rregullt, për një kohë të  
mirë. Në mëngjez futej në galeri, shtynte vagonat  
dhe shkonte në fund për t'i ngarkuar. Pas pak, me  
vagona të ngarkuar me mineralin e vlefshëm, du-  
kej për një çast te gryka e galerisë e përsëri hum-  
biste në thellësi. Duke punuar me ngulm e me vull-

net të papërkulur dhe duke racionuar mirë kohën, arriti shumë shpejt jo vetëm ta realizonte normën ditore, por edhe ta tejkalonte. Këtë gjë e panë edhe punëtorët e tjerë dhe ndoqën shembullin e tij. Dhe sukseset u dukën menjëherë. Gjithë sektori filloi të përparonte, filloi të dilte nga prapambetja e të realizonte rregullisht planin.

## X. MINA NË ÇENTRAL

Një ditë u dëgjuan shpërthime minash në qytet. Minatorët e Bulqizës janë të mësuar me shpërthime të tilla, sepse s'ka ditë që të mos dëgjosh në minierë mina që shpërthejnë nga të katër anët. Po këtë radhë ishte diçka e jashtëzakonshme. Minat shpërthenin njëra pas tjetrës brenda në qytet. Dhe jo vetëm kaq: zhurma e shpërthimit vinte nga çentrali elektrik; e pas zhurmës filloi të dukej edhe tymi... Ç'po ndodhte vallë?

Ata që nuk e dinin se si qëndronte puna, u habitën. Shumë prej tyre vrapuan menjëherë drejt godinës së çentralit, që të shikonin se mos kishte ndodhur ndonjë fatkeqësi. Ata e dinin mirë se çentrali elektrik ishte zemra e minierës. Energjia elektrike, si gjaku në një organizëm të gjallë, andej përhapej në të gjithë sektorët dhe në të gjitha galeritë. Dhe po të kishte ndodhur ndonjë fatkeqësi e të ndërpritej puna në çentral, qoftë edhe për një kohë të shkurtër, gjithë puna e minierës do të paralizohet menjëherë. Po ata që ju afruan të parët godinës së çentralit, u habitën shumë kur panë se punën e shpërthimit të minave e drejtonte vetë kryeinxhinieri i tyre. Dhe tani që minat kishin marrë fund,

Todua buzëqeshte i kënaqur, si një njeri që kish-te arritur një sukses të madh. Të tjerët që vinin, pyesnin me kureshtje të madhe:

— Ç'ka ndodhur, or djema? Ç'ka ndodhur?

— Hiç gjë, mos u shqetësoni! Çdo gjë vajti mbarë! — u përgjigjeshin ata të centralit, duke shkuar poshtë e lart me nxitim.

Atë ditë, gjithë banorët e Bulqizës bisedonin gjerë e gjatë për këtë ngjarje të çuditshme «Mina në central! S'na shkonte në mendje kurrë!» — thoshin midis tyre me një ton habie, po edhe admirimi të thellë për ata që e kishin organizuar atë punë.

Ç'kishte ndodhur?

Qysh në vitet e para të fillimit të punimeve, në Bulqizë ishin instaluar dy grupe të vogla elektrike, që furnizonin me energji sektorët e ndryshëm të minierës. Mirëpo miniera zhvillohej përditë me ritme shumë të shpejta, asaj i shtoheshin gjithnjë sektorë të rinj. Prodhimi shtoej, qyteti zgjerohej, nevojat për energji elektrike bëheshin më të mëdha. Prandaj, në vend të dy grupeve të vogla elektrike të vjetra, do të instaloheshin tani një grup elektrik i ri me një fuqi tri herë më të madhe nga ajo e të dy grupeve të marra së bashku. Dhe kjo punë duhej të bëhej sa më parë. Miniera nuk mund të priste. Ajo kishte nevojë për më shumë energji elektrike, për më shumë gjak industrial.

Ky grup i ri e i madh elektrik, që sapo kishte ardhur, do të instaloheshin në godinën e centralit të ndërtuar prej kohe, mirëpo bazamenti prej betoni i centralit ishte bërë për dy grupet e vogla, ai nuk ishte i përshtatshëm për grupin e madh që kërkonte

një bazament tjetër, më të fortë e më të trashë. Bazamenti i vjetër duhej të shkatërrohej në gjysmën e godinës, ku do të instalohej grupi i ri. Po që ta shkatërroje këtë bazament prej betoni nuk ishte punë e lehtë. Ai duhej gryer pak nga pak me kazmë, me qysqi e me çekiç rëzues. Mirëpo kjo mënyrë veprimi kërkonte shumë punë dhe shumë kohë, kurse nevoja e minierës për energji elektrike ishte e ngutshme. Ekzistonte edhe një mënyrë tjetër për prishjen e bazamentit të vjetër: ajo e hedhjes së tij në erë me anë të lëndës eksplozive. Kjo mënyrë jepte përfundime të menjëhershme, po paraqiste mjaft rreziqe: mund të prishej godina, mund të dëmtoheshin grupet e vjetra, që furnizonin edhe minierën me energji elektrike. Si do të bëhej? Filluan diskutimet, konsultimet, shfaqeshin mendime të kundërta. Pjesa më e madhe e teknikëve shfaqej haptazi për gryerjen e bazamentit të vjetër të çenralit me mjete dorë, me mjete primitive. «Kjo është mënyrë e sigurtë! — thoshin. — Do të bëhen shumë shpenzime, do të vonohet ca puna, po s'kemi ç'bëjmë! Ku është dëgjuar të vësh mina në çentral? Të vësh mina dy-tre metra larg grupeve elektrike që funksionojnë? Kjo është të vrasësh veten me duart e tua. Mirë po të dali me sukses, po sikur të dështojë?»

Todua dëgjonte, po nuk fliste. Po atë ditë në mbrëmje mbledhi në çentral zjarrmëtarët më me përvojë të minierës. U foli për çështjen që e preokuponte. Dëgjoi me vëmendje mendimet e tyre. Bashkë me ta bëri një provë në një barakë të vjetër e të shkatërruar. Natën, kur u kthye në shtëpi, hapi libra dhe manuale të ndryshme. Bëri vetë

shumë llogaritje. Dhe në fund mori vendimin:  
«Mina në central!»

— Të nesërmen në mëngjez filloi puna për vendosjen e minave. Todua e kishte marrë vetë drejtimin e këtij aksioni, si dhe përgjegjësinë për çdo gjë që mund të ndodhte. Dhe ja si u veprua. U hapën me martel në bazamentin e vjetër gjashtë bira në një thellësi prej tridhjetë centimetrash. Ato u ngarkuan me nga gjysmë kallëpi lëndë eksplozive. Pastaj mbi bazamentin u vendos një llamarinë e trashë. Mbi llamarinë grumbulluan pesha të rënda. Pasi mbaroi edhe kjo punë, u kontrollua mirë çdo gjë për herë të fundit. Pastaj u ndezën fitilat. Dhe minat shpërthyen me rrapëllimë. Bazamenti i vjetër u prish aq sa duhej dhe atje ku duhej. Centrali punonte normalisht. Asnjë ndërprerje në prodhim! Objektivi i caktuar ishte arrihur plotësisht. Tani mund të fillohej nga puna për hedhjen dhe betonimin e bazamentit të ri. Grupi i ri elektrik do të vendosej sa më parë dhe miniera do të kishte energji elektrike të mjaftueshme.

Hedhja e bazamentit të vjetër në erë me anë të lëndës eksplozive kërkonte kryesisht dy gjëra: guxim dhe njohuri të gjëra teknike e shkencore. Dhe të dyja këto nuk i mungonin aspak kryeinxhinierit të Bulqizës, Todo Manços. Kur erdhi puna që të merrte vendim, partizani i vjetër solli ndërmend raste të shumta të vështira nga koha e luftës, kur duhej të hidhej në sulm me guxim e vendosmëri. Dhe zemra e tij rrahu si atëhere....

## XI. NJË NJERI PUNON ME BEL NË FUSHË

Todua, megjithëse është larguar prej vjetësh nga fshati i lindjes, nuk e harron kurrë atë. Kur e pyeta njëherë se ku i kalonte ditët e pushimit vjetor, ai m'u përgjegj:

— Ku të ndodhë; këtu në Bulqizë, në plazhin e Durrësit, po më shumë në fshat, në Boboshticë.

Gruaja e tij më bënte shenjë me dorë se nuk ishte asthu siç thoshte ai.

— Sikur ka një vërejtje jot shoqe, o Todo?!

— Në qoftë se ka ndonjë gje, le ta thotë...

— E di si është puna? — e mori fjalën ajo.

-- Është e vërtetë se ne nisemi një herë në vit familjarisht për të kaluar pushimet vjetore në ndonjë vend; mirëpo Todua, pasi na çon atje, rri dy - tri ditë bashkë me ne e kris e ikën.

— Për ku?

— Për në minierë; ai s'mund të rrijë më shumë larg minierës.

— Ndodh ngandonjëherë edhe kështu, — tha qetë - qetë Todua.

— T'ishte vetëm ngandonjëherë!...

Njëherë u nis për në vendlindje fillikat. Asnjë njeri nuk e mori vesh mbritjen e tij në fshat, sepse ishte natë. Ai u drejtua menjëherë për në shtëpi. Ishte i lodhur nga rruga e gjatë. Bisedoi me njerëzit e tij për farefisën, për miqtë e vjetër, për punët e fshatit, për kooperativën bujqësore...

Të nesërmen, u ngrit shumë herët. Vajti te çezmja e lagjes për t'u larë me ujin e ftohtë të buri-

mit, siç vepron dhe në Bulqizë, pastaj u kthye në shtëpi, veshi kominoshet që kishte sjellë me vete, mori një bel nga plevica e vjetër dhe u drejtua nga qendra e kooperativës për t'u takuar me Kryetarin, ose me ndonjë nga brigadierët. Rrugës u ndesh me një brigadë të kooperativës që shkonte për të hapur toka të reja. Todua ju paraqit menjëherë brigadierit:

— Kam ardhur në fshat për të punuar bashkë me ju, — i tha. — Prandaj, të lutem, të më marrësh në brigadën tënde.

Bashkë me brigadën u nis edhe ai për në një djerrinë mjaft larg nga fshati. Rrugës filluan bisedat. Të moshuarit e njihnin mirë Todon dhe bisedonin me të si me një shok të vjetër.

Filloi puna për hapjen e tokave të reja. Todua e përdorte belin me shkathësi e mjeshtëri. Të tjerët e shikonin si me habi.

— Shoh se nuk e ke harruar punën e belit, o Todo, — i tha brigadieri në kohën e pushimit të drekës.

— Ato që njeriu i mëson në moshën e vegjëlisë, nuk i harron kurrë, — ju përgjegj me thjeshtësi Todua.

Bashkëfshatarët nuk e dinin se Todua nuk kishte shumë kohë pa e përdorur belin. Ai, bashkë me të rinjtë e minierës, kishte vajtur vullnetarisht për të ndihmuar kooperativat e reja malore të rrethit të Dibres për hapjen e tokave të reja.

Ato ditë, në një nga klasat e shkollës së Boboshticës, nxënësit kishin mësim një copë leximi që bënte fjalë për një hero të punës socialiste. Mësuesi, kur shpjegoi mësimin, u tha nxënësve:



— Edhe nga fshati juaj ka një hero të punës socialiste.

— E dimë! E dimë!— u përgjegjën horas nxënësit. — Është Todo Mançua!

Nga bankat e fundit një vajzë ngriti dorën e tha:

— Me leje, shoku mësues, Todua është këtu, në fshat.

— Ai punon në minierën e kromit në Bulqizë, — i tha mësuesi, që nuk dinte gjë.

— E di që punon në Bulqizë. Po ka dy - tri ditë që ka ardhur këtu, në fshat. Ai punon në një brigadë me babain tim.

Fëmijët u bënë kureshtarë. Dëshën të merrnin vesh në ishte e vërtetë ajo që kishte thënë shoqja e klasës... Këtë bisedë e vazhduan edhe pas mbarimit të mësimit. Aty nga mbrëmja, një grup nxënësisht u bashkuan në qendër të kooperativës dhe dolën jashtë fshatit, andej nga do të ktheheshin kooperativistët, që punonin në pllajën e malit. Brigada, në të cilën merrte pjesë edhe Todua, u kthye vonë atë ditë në fshat, sepse kishte për t'i dhënë fund punës për sistemimin e një parcele të porsahapur, që do të mbillej të nesërmen me patate. Fëmijët zunë një vend nga të dyja anët e rrugës dhe pritën gjersa u erdhën pranë ata të brigadës.

— Ai i dyti është, i dyti! — pëshpëriste një djalë që e kishte parë edhe një ditë më parë.

— Kush, o? Ai zeshkani?

— Po, po! Ai është Todua!

Fëmijët heshtën. Ata shikonin me admirim Heroin e Punës Socialiste, anëtarin e Komitetit

Qendror të Partisë dhe deputetin e Kuvendit Popullor, që, me belin në krah, kthehej nga puna për hapjen e tokave të reja bashkë me kooperativistët e tjerë...

## XII. STOLIA E TIJ MË E MIRË

Për cilësitë e rralla të karakterit të Todos punonjësit e Bulqizës flasin gjithnjë e më shumë. Mjafton që të përmendësh emrin e tij dhe menjëherë secili do të ketë diçka për të thënë. Po fjalë të mira dhe episode të bukura e interesante për jetën e tij mund të dëgjosh jo vetëm në Bulqizë, ku ai rron e punon, po kudo nëpër minierat dhe kantieret e shumta të vendit. Ata që e njohin më mirë, kanë shumë gjëra për të treguar. Disa nga ata vënë në dukje më shumë dashurinë e tij ndaj punës; disa të tjerë inisiativën dhe guximin që ai tregon në zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara të minierës. Ka edhe asish që flasin me admirim për kujdesin e madh që tregon ndaj minatorëve, ndaj shokëve të tij të punës. Po që të gjithë pajtohen plotësisht me një gjë: se stolia më e mirë e Todos është thjeshtësia.

Thjeshtësia e kryeinxhinierit të minierës së Bulqizës nuk duket vetëm në veshjen e tij prej punëtori, apo në gadishmërinë e tij që të flasë me çdo njeri. Ajo buron nga shpirti i tij i pastër e thellësisht popullor, prandaj duket në çdo çast në çdo veprim të tij. Thjeshtësia e tij tregon se ai është bir i popullit, se ai e do me gjithë shpirt popullin.

Emri i tij, gjatë këtyre dhjetë vjetëve të fundit, është bërë i njohur në të gjithë vendin. Kongresi i katërt i partisë e zgjodhi kandidat të Komitetit Qendror dhe Kongresi i pestë anëtar. Gjatë zgjedhjeve të fundit për organin më të lartë të vendit, populli i krahinës së Bulqizës e propozoi dhe e zgjodhi deputet në Kuvendin Popullor. Në shkurt të vitit 1968, Todua u shpall Hero i Punës Socialiste. Dhe thjeshtësia e tij jo vetëm që nuk u venit, po pikërisht, pas këtyre ngjarjeve të rëndësishme në jetën e tij, shkëlqeu me një forcë edhe më të madhe.

Para trembëdhjetë vjetësh, kur Todua u vendos familjarisht në Bulqizë, fqinjët e shihnin se si dilte mëngjez për mëngjez nga shtëpia dhe drejtohej për në çezmën e minierës, duke mbajtur dy gjyma të mëdhenj në duar. Atje, pasi lahej mirë e mirë dimër e behar, mbushte gjymat me ujë e kthehej në shtëpi. Pastaj, po të ishte dimër, merrte sëpatën në dorë e çante dru. Dhe gratë e lagjes thoshin midis tyre: «Ky inxhinier që na erdhi tani, i ndihmon gruas edhe në punët e shtëpisë».

Edhe tani ai ashtu e fillon ditën e punës: duke vajtur në çezmë për të mbushur gjymat me ujë e duke çarë dru me sëpatë. Kur vjen rasti e bisedohet për detyrën që kanë burrat për të marrë pjesë edhe në punët e shtëpisë, gratë e Bulqizës thonë: «Këtë punë Todua e bënte prej vjetësh. Jo vetëm tani që ky problem shtrohet me forcë nga partia, po që nga dita e parë që ai ka ardhur këtu, në minierën tonë».

Për thjeshtësinë e Todos mund të dëgjosh të

flitet jo vetëm në Bulqizë. Mjafton të udhëtosh goftë edhe një herë me kamionat që transportojnë kromin në Laç, që të dëgjosh nga shoferët «qyfyre» të shumta për thjeshtësinë e tij të jashtëzakonshme. Ja se ç'ndodhi një ditë në qendër të Bulqizës. Një kamion i ngarkuar kishte qëndruar në mes të rrugës. Pas tij erdhi një tjetër. Shoferi i kamionit të dytë i ra burisë, po kamioni i parë nuk lëvizi nga vendi. Kabina e tij qe bosh dhe shoferi se ku kishte vajtur. Atëhere shoferi i kamionit të dytë fiku motorin me nervozizëm dhe hapi derën e kabinës me inat. Në atë çast kaloi Todua, i veshur, si gjithnjë, me kominoshe.

— Ore shok! — i thirri shoferi i kamionit, — kështu lihet maqina, në mes të rrugës?!

Todua në fillim nuk e kuptoi se ç'deshte t'i thoshte shoferi i panjohur dhe e shikoi si me habi.

— Ty të them, ore, — i thirri me inat shoferi. — Hape rrugën shpejt, se kam një punë të ngutshme.

— Nuk kam çelësat e motorit, — ju përgjegi si me shaka Todua.

— Ama, shofer i mirë na qenke edhe ti! Të mos kesh me vete çelësat e maqinës!

— Epo, ja që ka edhe shoferë të tillë, — i tha Todua dhe vazhdoi rrugën e tij.

Atë çast nga ana tjetër e rrugës doli shoferi i kamionit të ngarkuar dhe i tha kolegut:

— Ç'pate që bëre fjalë me Todon?

— Me cilin Todo, ore?

— Me cilin Todo, thotë?! Me Todo Mançon.

— Unë Todo Mançon as që e njoh fare. Kam dëgjuar të flitet shumë për të, po nuk më është

dhënë rasti ta takoj ndonjëherë.

— Po ti tani fjaloseshë me të...

— Pse Todua ishte ai?!

— I tëri!

— Bobo! Ç'më thua, or vëlla? Unë e mora për shofer dhe i thashë gjithë ato fjalë. . .

— Për këtë bëhesh merak ti, o?! Hic mos u shqetëso. Todua nuk i vë re këto gjëra. Sa herë i ka ndodhur atij kështu. . .

Pas pak, shoferi i kamionit pinte kafe me Todon në klubin qendror të Bulqizës, duke biseduar përzemërsisht me të, sikur të ishin dy miq të vjetër. . .

Hajdar Mazari është një minator shumë i vjetër dhe i dalluar në minierën e Bulqizës; ai është edhe sekretar i organizatës bazë të pusit Nr.1. Në këtë organizatë merr pjesë edhe Todua.

«Në jetën time nuk kam parë njeri më të thjeshtë se Todon, — thotë Hajdari. — Ai është i thjeshtë në çdo gjë: në punë, në bisedë, në sjellje dhe në marrëdhëniet e tij me njerëzit. Unë jam në organizatën bazë të partisë bashkë me Todon. Shokët e organizatës gjatë këtij viti më zgjodhën mua si sekretar. Kështu që më takon shpesh t'i ngarkoj detyra partie si për prodhimin, ashtu dhe për aktivitete të ndryshme shoqërore. Todua më dëgjon me vëmëndje dhe mban shënime në një blok të vogël. Pastaj, në mbledhjen tjetër, raporton me fjalë të thjeshta e të qarta mbi punën që ka bërë dhe mbi rezultatet që ka arritur. Vetëm një gjë nuk i pëlqen. Ndodh shpesh që ta propozojnë për në presidiumin e mbledhjes, në shenjë respekti që ushqejnë për të. Ai në kësi rastesh ngrihet nga

vendi dhe u thotë atyre që e propozojnë: «Pse, s'ka njerëz të tjerë për në presidium? Zgjidhni më mirë ndonjë minator!»

### XIII. ZËRI I MASËS

Një ditë të ftohtë marsi u nisa qysh në mëngjez për në zyrat e drejtorisë së minierës.

— Todon nuk e ke këtu, — më tha shefi i planit të ndërmarrjes së shfrytëzimit të kromit shoku Agim Fetiu. — Ai është nisur për në minierë.

— Eja të rrimë ca në zyrën time — më propozoi kryegjeologu i minierës, Jorgo Kola. — Todon mos e prit tani. Ai, po të futet në galeri, harron të dalë së andejmi.

Kryegjeologu më tregonte disa harta, që nuk paraqisnin sipërfaqen e tokës, po rjetin e dendur të galerive dhe trupin e kromin që fshihet në thellësit e tokës. Duke shikuar hartat, ai më fliste për perspektivat e minierës. Biseda bëhej shumë interesante, sepse gjeologët, kur flasin për të ardhmen, u zgjidhet gjuha. Befas dikush trokiti në derë.

— Kush do të jetë vallë në këto orë? — tha Jorgua si me vete, i mërzhitur ca që na u ndërpre biseda.

Dera u hap me ngadalë dhe një grua hyri si me drojtje brenda.

— Urdhëro, Vezire, hyrë brenda, — i tha kryegjeologu.

— Erdha të takoj Todon, po nuk e gjeta në zyrë. Mos e di se kur kthehet?

— Ai nuk besoj të kthehet paradite. Duku njëherë pasdite.

— Pasdite i shkoj edhe në shtëpi, po thashë se mos ishte tani, se kam një hall të madh, Jorgo.

— Po të kesh ndonjë hall që s'pret, shko në degën e kuadrit, moj Vezire. Atje e ke përgjegjësin.

— Hallin tim vetëm Todua mund të ma rregullojë. Se është një plagë e vjetër, që ai e di mirë...

Vezirja është një punëtore e thjeshtë, që punon në mirëmbajtjen e pallateve. Në zyrat e drejtorisë kishte ardhur për një çështje familjare. Dhe i qe tiposur mirë në mendje se këtë çështje vetëm 'Todua mund ta zgjidhte. Me pak fjalë, ja se si qendronte puna. Burri i saj pinte shumë. Këtë ves ai e kishte prej kohësh, po herë e mbante veten, herë të tjera e humbte vullnetin dhe bëhej përsëri skllavi i vesit. Një ditë më parë kishte marrë rrogën e pesëmbëdhjetëditshit dhe ishte bërë tapë. Ndaj edhe në mëngjez s'kishte vajtur fare në punë. Kjo e kishte shqetësuar shumë Veziren dhe mendoi të këshillohej njëherë me Todon. Mandej mendimi i saj ishte që vetëm Todua të bisedonte me burrin e saj. Këtë gjë ajo na e tha hapur.

— Vetëm fjala e Todos mund ta bëjë atë që t'i vërë gishtin kokës. Edhe njëherë tjetër, që kishte nisur të pinte, na erdhi Todua në shtëpi dhe e bëri të linte rrugën e keqe që kishte marrë. Po ja që edhe të pirit është si puna e sëmundjes, që, po s'e luftove gjer në fund, të zë përsëri.

Unë e shikoja Veziren si i menduar e plot habi.

— Mos u çudit, — më tha Jorgua, kur doli Vezirja nga zyra. — Kjo ndodh shpesh këtu te ne. Punëtorët e minierës e shikojnë Todon jo vetëm si krye-

inxhinier të ndërmarrjes së tyre, po edhe si një baba të dhimbsur e të mençur. Prandaj vinë e bisedojnë me të për çdo gjë: për çështje pune, për çështje familjare, e për çdo gjë tjetër. E pe Veziren? Ajo ka bindje të plotë se burri i saj, po ta thërrasë Todua e t'i flasë njëherë mirë e mirë, do të ndërrojë rrugë. Këtë gjë mund të shikosh edhe ndër të tjerët. Të gjithë punonjësit e minierës kanë bindje të plotë se Todua është njeri i drejtë dhe u thotë të gjithëve të vërtetën në sy: edhe kur është e këndëshme, edhe kur është e hidhur...

Ja se ç'ndodhi njëherë me një minator të vjetër. Minatori kish kërkuar banesë në Bulqizë, megjithëse kishte pasur shtëpinë e tij në fshatin e lindjes, që nuk ishte më larg se 2-3 kilometra nga miniera. Atëhere, atyre që kishin banesa afër, nuk u jepej shtëpi në qytet. Ndaj ai vajti te Todua, i cili e dëgjonte me durim gjer në fund. Pastaj ju këthye minatorit dhe i tha prerazi:

— Shumë mirë kanë vepruar, Nezir, ata të pushtetit. Ti nuk ke të drejtë të marrësh shtëpi në qendër të Bulqizës, se je fare pranë qytetit.

— Si s'kam të drejtë, o Todo? Kam katërmbëdhjetë vjet që punoj në minierë.

— Kjo është e keqja e madhe, Nezir, që pas katërmbëdhjetë vjetësh pune në minierë vazhdon të kesh pretendime të padrejta. Atëhere ç'mund të presim nga ata që na erdhën dje?

Dhe me durim të madh vazhdoi t'i shpjegonte hollësisht pse s'kishte të drejtë dhe si duhej të vepronte. Minatori i vjetër dëgjoi me vëmendje fjalët e Todos dhe pasi u mendua mirë, bëri auto-kritikë të hapur e të sigurtë në mbledhjen e parë



të kolektivit. Duke bërë fjalë për përgjigjen e Todua, ai tha: «Todua më bëri që ti vë gishtin kokës e të mendohem mirë. Në fillim më erdhi si e hidhur përgjigja e tij. Po tani e kuptoj fare mirë se sa e drejtë ka qenë. Me këtë rast kuptova edhe diçka tjetër: se Todua nuk të sorollat me sot e me nesër. Ai ta thotë troç, në ke të drejtë ose jo. Po edhe kur të thotë se s'ke të drejtë, ta shpjegon mirë arsëyen. Prandaj kanë shumë të drejtë ata shokë që thonë se ai flet rrallë, po kur flet, i bie në shenjë. Fjala e tij saldon...»

Hasan Jashari është një nga minatorët më të vjetër të Bulqizës. Ai ka më se tetëmbëdhjetë vjet që punon në minierë. «Todua, — thotë Hasani, — na vjen përditë në galeri. Na pyet për shëndetin, për punën e për vështirësitë që hasim në punë. Kur e kërkon gjendja, ai merr vetë martelin dhe punon si një minator i thjeshtë. Prandaj edhe ne minatorët e duam shumë, se e kemi si njeri tonin. Po ai nuk na vjen vetëm në galeri. Kur kemi ndonjë hall, a ndonjë gëzim familjar, ai na vjen edhe në shtëpi. Dhe ne e presim me zemër të hapur, si njeri të shtëpisë. Edhe kur të bërtet Todua, s'të vjen keq, se të bërtet për të mirën e punës; e, po ta marrësh hollë - hollë, edhe për të mirën tënde. Prandaj e di si themi ne, minatorët? Po të na largohet ndonjëherë Todua nga miniera, do qajnë edhe gurët, do qajë edhe mali i Bulqizës, që ai e ka shkelur kryq e tërthorë».

Ka shumë fakte që flasin qartë për kujdesin e madh që tregon Todua për jetën e për shëndetin e njerëzve të minierës.

Tërmeti i tridhjetë nëndorit të vitit 1967, që ra në rrethet e Dibrës e të Librazhdit, u ndje fort

edhe në Bulqizë. Gjithë mali i Bulqizës u lëkund nga një forcë e madhe. Ishte ende herët dhe Todua, n'atë çast që ra tërmeti, gjendej në takimin e shkurtër të mëngjezit, që quhet «pesëminutshi». Në këtë takim merrnin pjesë inxhinierët e minierës së kromit, teknikët e sektorëve dhe përgjegjësit e zonave. Befas gjithë vendi u tund nga themeli dhe puna u ndërpre. Në çastet e para, njerëzit shikonin njëri tjetrin si të hutuar. Todua u ngrit menjëherë dhe, pa humbur gjakftohtësinë, u thirri me zë të vendosur pjesëmarrësve të takimit: «Shokë! Të sulemi nëpër galeritë. Secili në zonën e vet. Të shohim se mos na kanë pësuar gjë njerëzit!» Dhe vetë vrapoi nga të parët drejt galerive të minierës. Tronditja nga tërmeti kishte qenë e madhe edhe në thellësitë e tokës, në ballin e galerive ku punohej për nxjerrjen e kromit. Po nuk kishte ndodhur asnjë shembje e rrezikshme. Sistemi i sigurimit të minierës e kishte kaluar provën e madhe me sukses të plotë. Kur u kthyen përsëri në qendër dhe u mblodhën informatat e para nga të gjithë sektorët e minierës, Todua tha i lehtësuar:

— Kryesorja është se s'kemi dëme në njerëz. Të gjitha të tjerat ndreqen, dhe mund të ndreqen shumë shpejt!

Niko Lula është inxhinier i ri. Para tre - katër vjetësh ka dalë nga bankat e Universitetit Shtetëror të Tiranës. Punon në një sektor shumë të vështirë të Bulqizës: në shpimin e pusit Nr.2, i cili, kur të përfundojë, do të jetë pusi më i thellë në vendin tonë. Në punën e tij të përditshme është njohur mirë me Todon dhe ndjen admirim për të.

— Me Todon nuk na lidh puna drejtpërsëdrejti,

— thotë inxhinieri i ri. — Ne varemi nga një ndërmarrje tjetër dhe punojmë për hapjen e një pusi, që do të hyjë në funksionim pas disa vjetësh. Po Todua nuk interesohet vetëm për problemet e ditës së minierës. Ai e di mirë ç'rëndësi ka ky pus për të ardhmen e minierës. Prandaj interesohet nga afër për punën dhe hallet tona. Kur mori vesh se në thellësi të pusit plasi si rrebesh i nëndheshëm uji, Todua erdhi vetë, zbriti në pus dhe na dha disa këshilla shumë të vlefshme se si të vepronim, që të mos ndërpritej puna për shpimin e pusit. Todua tregon interesim për mbarëvajtjen e punës në të gjithë sektorët dhe në të gjitha ndërmarrjet e Bulqizës... Kam marrë vesh se ke ndërmend të bësh një libër për Todon,—vazhdoi inxhinieri.— Shumë mirë do të bësh. Po për atë s'mjafton një libër».

S'ka sektor pune në Bulqizë ku të mos ndjehet ndikimi dhe kujdesi i Todos. «Todua na ndihmon mjaft edhe në punën e shkollës,—thonë arësimitarët e shkollës tetëvjeçare të Bulqizës.—Kur kemi ndonjë problem të rëndësishëm për të shtruar ai na vjen edhe në mbledhjet e këshillit pedagogjik dhe na bën vërejtje e propozime të vlefshme për përmirësimin e punës sonë lidhur me edukimin e fëmijëve. Para disa ditësh na dhuroi një koleksion fotografish nga jeta e minierës dhe ne organizuam një ekspozitë, që tërhoqi vëmendjen e nxënësve të shkollës sonë».

«Po ku gjen kohën që të zhvillojë një aktivitet kaq të gjërë?» — mund të pyesë dikush.

Çdo gjë e bën me plan e me llogari. Prandaj i mbetet kohë të merret edhe me sport e me punën kulturale në minierë.

Kështu ai jo vetëm që shkron me qejf në të gjitha çfaqjet e grupeve amatore të Bulqizës, po jep ndihmën e tij të vlefshme gjatë provave dhe ndihmon shumë në aktivizimin e punëtorëve në punë kulturele. Regjizorja diletante e grupit të estradës së minierës deshte të hiqte dorë nga aktiviteti kultural për disa arsye vetjake. Todua gjeti rastin dhe bisedoi me të dhe në fund i mbushi mendjen që të vazhdonte të drejtonte grupin amator të estradës.

Mund të radhiteshin me qindra fakte të tilla, që në thelb tregojnë një gjë të madhe: pasionin e flakët të Todos për punën. Ndoshta kjo është arsyeja kryesore që minatorët e Bulqizës e kanë në zemër dhe kanë njëmijë gjëra të mira për të thënë për të. Mendimin e minatorëve për Todon mund ta përmbledhim me fjalët e thjeshta të minatorit veteran, Hasan Jashari: «Ai është safi komunist».

Kjo dashuri e madhe dhe e thellë e minatorëve për Todon u shpreh me forcë edhe atë ditë të paharruar shkurti të vitit 1968, kur miniera e Bulqizës festonte njëzetvjetorin e saj. Në çastin kur kryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor, shoku Haxhi Lleshi, lexoi vendimin e Presidiumit për shpalljen e Todos si Hero i Punës Socialiste, gjithë kinemaja e Bulqizës u ngrit në këmbë dhe gjëmoi nga brohoritje të fuqishme. Dhe menjëherë ajo pasdite e fortë e shkurtit u kthye në një festë të madhe e të ngrohtë për gjithë minatorët dhe banorët e tjerë të Bulqizës, që kanë në gjirin e tyre Todon.

#### XIV. «NE E KRITIKOJMË ATE VETËM PËR NJË GJË»

Minatori i vjetër i Bulqizës Mehmet Kiça tregon:

— Për Todon, secili nga ne mund të flasë me orë të tëra. Po dua t'ju tregoj një ngjarje të vjetër. Mund të kenë kaluar dhjetë—dymbëdhjetë vjet prej asaj dite. Por aq përshtypje të madhe më ka bërë, sa që e mbaj mend sikur të ketë ndodhur dje... Ishte pasdite e zyrtë dimri, aty ndaj të ngrysur. Unë isha kthyer nga galeria dhe kisha vajtur në ofiçinën e ndërmarjes për një detal të vogël, që na nevoitej të nesërmen në punë. Pjesa më e madhe e punëtorëve të ofiçinës kishin dalë, se qe bërë vonë. Në ofiçinë kishte mbetur një tornitor dhe unë. Tek ishim duke punuar me torno, dëgjuam një zhurmë të madhe e të çuditshme. Në fillim na u duk sikur rrokulliseshin gurë të mëdhenj nga mali. Shikuam njëri tjetrin, sikur donim të pyesnim se ç'po ndodhte. Zhurma po afrohej gjithnjë e më shumë. Ajo ishte një zhurmë, si ta quash, metalike; të jepte përshtypjen sikur dikush godiste papushim me gurë një copë teneqe të madhe. Po çudia ishte se kjo zhurmë po afrohej gjithnjë drejt ofiçinës. Atëhere unë vrapova drejt derës së ofiçinës, që të shikoja se ç'po ndodhte. Kur ç'të shoh? Todua, që atëhere sapo kishte ardhur në minierë, po zvariste me vështirësi mbi gurët një fletë të madhe llamarine, që e kishte gjetur të braktisur lart, në minierë. Rruga qe e gjatë, pesha e llamarinës e madhe dhe ai ishte bërë qull në djersë. E kapa llamarinën nga

ana tjetër dhe të dy së bashku e futëm në sallën e madhe të ofiçinës. Tornitori ndërpreu punën dhe ju afrua Todos:

— Nga e solle? — e pyeti ai.

— Lart, nga mali.

— Çudi si paska mbetur atje!

Sa materiale ka akoma të shpërndara andej këndeje!

— Edhe llamarinë ka?

— Unë këtë fletë që gjeta jua solla. Besoj se ju nevojitet. . .

— Edhe pyet? Këtu në ofiçinë na hyn në punë edhe një gozhdë, një copë hekuri, jo kjo alamet fletë llamarine. Lere pastaj që kemi edhe kovaçanën këtu. . .

Todua doli i menduar. Fjalët e tornitorit i bënë përshtypje. Qysh prej asaj dite ai filloi të mbledhë çdo gjë metalike që gjente rrugës. Disa herë në javë shkonte në bazën mekanike dhe zbraste nga xhepi gozhdë shinash, steka e materiale të tjera të imta. Njerëzit asokohe e shikonin të çuditur, kur ai mblidhte rrugëve çdo gjë që gjente. Ka pasur edhe nga ata që shtrembëronin buzët kur shikonin kryeinxhinierin e ndërmarrjes së tyre që merrej «me gjëra të vogla». Po ai vazhdonte punën e vet, pa u dhënë rëndësi fjalëve dhe thashethemeve të botës. Kur e sillte fjala, ai u thoshte të tjerëve: «Kur i shoh të hedhurá andej këndeje këto hekurishte, që duken si të pavlefshme, po që na nevojiten shumë, më duket sikur ngrihen nga toka, më hidhen në fytyrë e më shpojnë sytë».

Ashtu si vepronte para pesëmbëdhjetë vjetëve për mbledhjen e hekurishtave, ashtu bën edhe sot.

Po tani s'ka më njerëz që të shtrembërojnë buzët. Se tani këtë punë e bëjnë dhe shumë të tjerë. Në çdo kënd të qytetit e të minierës do të shikosh kuti të mëdha e të vogla, ku mbledhen materiale, që në shikim të parë duken si të pavlefshme. Shembulli i Todos dhe këmbëngulja e tij për të mbledhur çdo gjë që mund t'i hyjë njeriut në punë, ka qenë për ne dhe vazhdon të jetë edhe sot një thirrje e heshtur, një thirrje pa fjalë.

Kamber Duriçi, shoku i ngushtë i Todos, që e zëmë në gojë edhe më lart, na tha edhe këtë gjë:

— Ne, miniatorët, e duam shumë Todon. Po edhe ai na do shumë. Unë kam afro pesëmbëdhjetë vjet që njihem me të dhe jemi bërë miq të ngushtë, vëllezër mund të thuash. Unë s'mund të rri pa e takuar Todon një herë në ditë. Në disa raste edhe jam zënë me të. Për çështje pune sigurisht. Ja shkaku që zihemi ngadonjëherë: ai është shumë dorështrënguar kur vjen puna për të dhënë materiale; sikur i jep nga xhepi i tij. Kur i gojmë ndonjë shkresë për ta firmosur për të na dhënë materiale, ai mendohet shumë para se ta firmojë. Prandaj ne e kritikojmë vetëm për një gjë: është shumë kurnac në dhënjen e materialeve.

## XV. BILANCI I GJERTANISHËM I NJË JETE

E ardhmja e minierave të Shqipërisë! Kjo është tema më e preferuar e Todos. Mjafton që ta sjellësh bisedën atje, për të dëgjuar nga ai fjalë

plot pasion për zhvillimin e minierave në vendin tonë. Ai, që zakonisht rri i heshtur e i menduar ose flet fare pak, kur preket ky problem, merr zjarr menjëherë e të shpjegon me durim gjëra shumë interesante për të ardhmen e shkëlqyer të industrisë sonë minerale, e në mënyrë të veçantë të asaj të kromit.

Një ditë, ndërsa ishte duke folur për të ardhmen e minierës, më erdhi ta ndërprisja e ta pyesja: «Todo, si të lindi në shpirt ky pasion i madh dhe kjo dashuri e thellë për kromin?». Po m'u kujtuan fjalët e shokëve të tij të ngushtë, që më kishin thënë një ditë më parë: «Todua tregon një interesim jo vetëm për kromin, po për të gjitha mineralet që nxirren te ne. Dhe është i informuar sa asnjë tjetër prej nesh mbi punën e minierave tona». M'u kujtuan edhe fjalët që më kishte thënë vetë për kohën kur kishte qenë në drejtorinë e minierave në Tiranë: «Më ka mbetur peng që nuk arrita asokohe të vizitoja të gjitha minierat e vendit».

Po ashtu si sjell fjala fjalën, edhe mendimi sjell mendimin dhe padashur më erdhën ndërmend fjalët që ishin përhapur kudo, se Todon kishin dashur ta transferonin në Tiranë e ta bënin zëvendës ministër, po ai nuk kishte pranuar.

— A janë të vërteta fjalët që thuhet për transferimin tënd në Tiranë? — e pyeta, pasi mori fund biseda mbi të ardhmen e minierave të vendit tonë.

— Unë jam ushtar i partisë, — m'u përgjegj pak si tërthorazi. — Dhe, si ushtar, jam gati të shkoj në çdo minierë të Shqipërisë; qoftë në mini-



erat më të vjetra, ku puna është vënë pak a shumë në vijë, qoftë në minierat e reja, që janë zbuluar gjatë viteve të fundit dhe janë ende në hapat e tyre të para. Po në administratë nuk më pëlqen. Dhe kur një punë s'të pëlqen, s'ke si ta kryesh si duhet dhe të arrish përfundime të mira. Ja, kjo është e tëra...

Sa më shumë njihesh me Todon, aq më tepër të mira zbulon në karakterin e tij. Sa më shumë njerëz të pyesësh për të, aq më tepër fjalë të mira do të dëgjosh për këtë njeri të thjeshtë, që punon ditë e natë, pa zhurmë e pa reklamë, në një sektor sa të vështirë, aq edhe të rëndësishëm të ekonomisë sonë popullore. Dhe, kur flet masa, kur flet populli, flet vetë e vërteta.

Kur njihesh personalisht me Todon, kur e sheh se si punon, si merret me aktivitete shoqërore, se si bisedon me minatorët e me punonjësit e tjerë në orët e lira, pas punës së lodhshme të minierës, thua me vete: «Ç'njerëz të mrekullueshëm ka farkëtuar partia brenda në më pak se tridhjetë vjet.»

Njerëz të tillë, të apasionuar për punë, njerëz me tipare të reja, që janë gati të shkrijnë të gjitha forcat e tyre për të mirën e popullit e të atdheut, janë si monumente të gjalla të epokës së madhe të partisë. Ata janë kalitur në zjarrin e luftës së madhe nacional-çlirimtare për lirinë e popullit, ata janë farkëtuar në kudhrën e punës së pandërprerë për ndërtimin e socializmit.

Todua është shpallur Hero i Punës Socialiste në shkurt të viti 1968. Para tij janë shpallur dhe heronj të tjerë. Në të ardhmen do të shpallen edhe

të tjerë, sepse është një armatë e tërë njerzish të kohës sonë, që luftojnë ditë e natë për të vënë në jetë mësimet dhe porosit e partisë, «busullës së jetës tonë,» busullës së pagabuar të gjithë veprimtarisë sonë.

Ashtu si shumë të tjerë, edhe Todua ka bërë një rrugë të gjatë luftrash e përpjekjesh për një ideal të lartë e të ndritur. Bilanci i jetës së tij është i pasur: pesë vjet luftë kundër fashizmit, tre vjet luftë të armatosur kundër armiqve më të egër të këtij vendi e të këtij populli, duke ecur hap pas hapi në rrugën e çarë nga partia; afro njëzet e pesë vjet — një çerek shekulli — punë e përpjekje për ndërtimin e jetës së re, duke zbatuar me përpikmëri mësimet dhe porositë e partisë.

Në beteja e përpjekje të tilla është kalitur karakteri dhe është formuar personaliteti i tij. Djaloshit të vitit tridhjetenëndë, që grisi letrën e bardhë të hartimit përpara syve të mësuesit fashist, i është dashur të kalojë një rrugë të gjatë e të vështirë, që të bëhej Hero i Punës Socialiste. Kjo rrugë ka pasur kthesa, të përpjeta e tatëpjeta, po ka qenë gjithnjë ajo rrugë që ka çarë partia...

Gjatë kësaj kohe, Todua, përveç punës praktike, ka bërë përpjekje të mëdha për të përvetësuar bazat e teorisë marksiste. Puna e përditshme nuk e ka penguar kurrë nga studimi. Ai vazhdimisht ka gjetur kohën për të studjuar sa më thellë dokumentat e partisë sonë, veprat e shokut Enver, Klasikët e marksizëm-leninizmit. Si bir besnik i partisë, si komunist i vjetër, ai e ka kuptuar mirë se përvetësimi i teorisë marksiste-leniniste është një detyrë që nuk mbaron kurrë...

Todua është edhe kryeinxhinier i një ndërmarrjeje të madhe minerale, me probleme shumë të mëdha, të ndërlikuara. Për zgjidhjen e këtyre problemeve, për veç të tjerave, nevojitet edhe përvetësimi i shkencës moderne mbi minierat. Prandaj ai, krahas studimit të marksizëm — leninizmit, kurrë nuk ka pushuar së studjuari literaturën tekniko - shkencore të degës së tij.

Duke biseduar me bashkëpunëtorët më të ngushtë të Todos mbi këtë problem, ata më thanë: «Kur e shikon kështu Todon, me atë kapotën e vjetër ushtarake e me rrobat e punës, nuk të shkon kurrë mendja se ke të bësh me një njeri që lexon libra në katër — pesë gjuhë të huaja. Tani, kur po i afrohet të pesëdhjetave, i është përveshur punës për të mësuar gjermanishten. Kur e morën vesh këtë gjë, u habitën. Po ai na tha me thjeshtësinë e tij të zakonshme: «Ka literaturë të pasur për minierat edhe në gjuhën gjermane. Prandaj do të na hyjë në punë me siguri».

Njohuritë teknike - shkencore që merr nga libra e revista ai nuk i mban të vdekura në kokë, po përpiqet t'i vejë në jetë sa më shpejt që të jetë e mundur. Për çdo gjë të re që gjen në libra, i bën pyetje vetes: «Si mund të zbatohet kjo në minierën tonë? Në të gjitha bisedat që bëhen rreth problemeve të teknikës moderne të shfrytëzimit të minierave, ai merr pjesë aktive. Dhe gjithnjë del qartë kujdesi i tij i madh dhe përpjekjet që bën për të bashkuar sa më ngushtë njohuritë teorike që merr nga libra e revista, me të dhënat e praktikës, me problemet e minierës ku punon.

Në konferencën e parë teknike - shkencore

të gjeologjisë e të minierave, që u mbajt në Bulqizë përpara një viti, Todua bëri një diskutim shumë interesant dhe të vlefshëm, duke theksuar: «Duhet të provojmë më me guxim dhe në një shkallë më të gjërë metoda të reja shfrytëzimi në minierën tonë. Po asgjë nuk duhet marrë në mënyrë absolute. Çdo metodë e re duhet çmuar sipas përfundimeve që jep. Duke bërë përpjekje për të përvetësuar të renë, vetë praktika do të na mësojë se cilat nga metodat e reja na përshtaten në plotësisht e cilat duhet të adoptohen, në kushtet konkrete të nxjerrjes së kromit në Bulqizën tonë...»

Ditën që do të largohesha nga Bulqiza, pashë se shokët e tij të minierës kishin për të thënë edhe shumë gjëra rreth punës dhe aktiviteteve të tjera të Todos. Një gjeolog që punon në minierë më tha: «Mos mendo se kemi mbaruar! Jo, or vëlla! Ne, që e shohim përditë Todon dhe kemi të bëjmë orë e çast me të, mund të tregonim edhe shumë ngjarje të tjera dhe episode interesante nga jeta e tij e përditshme. Po tërë këto tregojnë mbi të gjitha një gjë: dashurinë e tij të madhe e të thellë për punën; për çdo punë në përgjithësi e për punën e minierës në veçanti. Ne, kur e shohim Todon se me çpasion i përvishet punës, gjersa e mbaron, shumë herë themi midis nesh: «Sikur të ishte e mundur të vinin nga të gjitha anët e vendit të rinjtë e të rejtat, që ta shikonin se si punon në galeri, në zyrë, në fushë e kudo ku e thërret detyra! Ata do të përfitonin shumë nga shembulli i tij vetjak, që edhe ne na elektrizon e na bën për vete. E, meqë një gjë e tillë nuk ka mundësi të bëhet, le ta plotësojë këtë punë, qoftë edhe pjesërisht,

libri për jetën dhe punën e Todos. Nga një libër i tillë, rinia do të marrë vesh disa aspekte kryesore nga jeta e tij, që do t'i vlejné shumë. Kjo do të jetë një kënaqësi edhe për vetë Todon, i cili e do shumë rininë dhe interesohet në mënyrë të veçantë për të...»

Në çastin e ndarjes, pyeta Todon:

— A ke ndonjë dëshirë t'ja çfaqësh rinisë së vendit tonë?

Ai u mendua njëherë mirë, pasta m'u përgjegj shkurt:

«Rinia të dojë punën! Kjo është kryesorja. Dua të them të dojë çdo punë, sado e vështirë që të duket në shikimin e parë. Rinia jonë të ndjekë me vendosmëri rrugën e drejtë në të cilën e drejton partia!»

# L E N D A

## Faqe

I. Në vend të parathënjes. . . . .	3
II. Hapat e para në jetë . . . . .	4
III. Komunisti i orës së parë. . . . .	10
IV. Sot lypset me armë malit të dalim . . . . .	18
V. Busulla e jetës. . . . .	31
VI. Universiteti i praktikës. . . . .	36
VII. Ai dhe kolektivi . . . . .	39
VIII. Çdo ditë bëhemi më të mençur. . . . .	43
IX. Ai punoi si vagonist . . . . .	48
X. Mina në central . . . . .	51
XI. Një njeri punon me bel në fushë . . . . .	55
XII. Stolia e tij më e mirë . . . . .	58
XIII. Zëri i masës. . . . .	62
XIV. «Ne e kritikojmë atë vetëm për një gjë». . . . .	69
XV. Bilanci i gjertanishëm i një jete . . . . .	71